

Përkthimi i certifikuar nga gjuha frënge

Qendra universitare Romand e mjekësisë ligjore

Njësia romande e mjekësisë forenzike

Chemin de la Vulliette 4, CH-100 Lausanne 25

Prof. Dr. mej. Tony Fracasso  
Mjek shef, përgjegjës

Dre mjek Claudia Castiglioni  
Mjeko ndihmëse, përgjegjëse për faqen e Lausanne

Tel.: 021 314 70 70

[www.curml.ch](http://www.curml.ch)

Lausanne, më 14 shtator 2019

N/ref : 19-T03497 – vic  
V/ ref. PPN / I nr. 461/16

Ne kemi pranuar nga z. Metush Biraj, Prokuror kombëtar i Republikës së Kosovës, një pako të datës 5 shkurt 2018, në kudër të një kërkesë të ndihmës së ndërsjellë ndërkombëtare. Kjo pako i është drejtuar Qendrës Universitare Romand të Mjekësisë Ligjore me kërkesë për të ndërmarrë të gjitha hetimet e pavarura të nevojshme për të ndriçuar vdekjen e :

**Z. DEHARI Astrit**

I lindur më 26 shkurt 1990

I mbajtur në qendrën e paraburgimit në Prizren (Kosovë)

Vdekja konstatohet më 05 nëntor 2016 në 15:55

**Ekspertiza jonë bazohet mbi:**

Studimin e dosjes të lëshuar në procedurë (versioni në anglisht) të veçantë:

- o Kërkesë për Asistencë Juridike të Dyanshme në Çështjen Penale të 05 shkurtit 2018,
- o Raporti (“oficial memorandum”) që përmbledh hetimet e drejtorisë e policisë rajonale të Prizrenit e pa datë,
- o Raportin e “Agjencisë Kosovare të Forenzikës” të 30 nëntorit 2016 që ka të bëjë me tri regjistrime video,
- o Raportin e “Federal Entity of Criminology” të Ministrisë së Punëve të Brendshme austriake të 23 gushtit 2017 që lidhet me tri regjistrimet video,
- o Raportin daktiloskopik të “Agjencisë Kosovare të Forenzikës” të 18 nëntorit 2016,

- Raportin e ekspertizës gjenetike të “Agjencisë Kosovare të Forenzikës” të 25 nëntorit 2016,
- Raportin e ekspertizës së grafologjisë të “Agjencisë Kosovare të Forenzikës” të 06 dhjetor 2016,
- Raportin e ekspertizës psikiatrike të Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës të 16 dhjetorit 2016,
- Procesverbalet e audiencave,
- Raportin e “Agjencisë Kosovare të Forenzikës” për vendin e zbulimit të trupit të z. DEHARI Astrit,
- Albumin e fotografive të vendit të zbulimit të trupit të z. DEHARI Astrit,
- Raportin e autopsisë së z. DEHARI Astrit, të Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës pa datë,
- Videot e autopsisë së z. DEHARI Astrit, të “Agjencisë Kosovare të Forenzikës”,
- Fotografitë e albumit fotografik të autopsisë së z. DEHARI Astrit “Agjencisë Kosovare të Forenzikës”,
- Fashikullin e “profil” të mbajtësit z. DEHARI Astrit sipas qendrës së qendrës së paraburgimit të Prizrenit pa datë,
- Raportin e gjendjes psikologjike të paraburgosurit z. DEHARI Astrit të datës 06 shtator 2016,
- Raportin mbi historinë sociale të z. DEHARI Astrit sipas qendrës së paraburgimit në Prizren pa datë
- Një analizë e re dhe interpretimet:
- Video dhe fotografi të autopsisë së z. DEHARI Astrit
- Prerjet histologjike të autopsisë së z. DEHARI Astrit
- Album fotografish të vendit ku është zbuluar trupi i z. DEHARI Astrit
- Studim të literaturës shkencore.

Ekspertiza jonë përbëhet nga :

- I. RIKUJTIME DHE FAKTE
- II. PËRMBLEDHJE E ELEMENTEVE TË PROCEDURËS
- III. ANALIZA TË REJA DHE INTERPRETIME TË DISA ELEMENTEVE TË PROCEDURËS NGA CURML
- IV. PËRMBLEDHJE DHE DISKUTIME
- V. PËRFUNDIMET
- VI. BIBLIOGRAFIA
- VII. VËREJTJE DHE PROPOZIME

(shkrimi në italik i tekstit): vërejtjet e ekspertëve.

## I. RIKUJTIME DHE FAKTE

Më 05 nëntor 2016, pak pas orës 15:00 z. DEHARI Astrit është gjetur i pajetë në qelinë A3 të qendrës së paraburgimit të Prizrenit në Kosovë, ku ai ishte mbajtur për terrorizëm dhe posedim ilegal të armës. I transportuar në spitalin rajonal të Prizrenit, vdekja e tij është konstatuar në ora 15:55 të njëjtën ditë.

Trupi i pajetë i z. DEHARI Astrit është gjetur nga tre bashkë të mbajturit, pas kthimit nga shëtitja në të cilën z. DEHARI Astrit nuk kishte dalë sepse ndjehej keq. Në momentin e zbulimit të trupit, z. DEHARI Astrit pushonte i shtrirë mbi tokë në shpinë, me një shishe mjalti prej plastike në gojë. Një autopsy mjeko-ligjore është kryer mbi trupin e pajetë të z. DEHARI Astrit në Institutin e Mjekësisë Ligjore të Kosovës. Raporti i autopsisë ka konkluduar për një asfiksi mekanike me obstruksion të rrugëve respiratorë superiore me një objekt me qëndrueshmëri të fortë dhe me një ndalesë refleksi kardiak. Në mes tjerash, lëndimet në nivelin e qafës dhe të kyçit të dorës së majtë janë përshkruar si të vetë-shkaktuara. Në përfundim të hetimit, është përfunduar se z. DEHARI Astrit kishte kryer vetëvrasje duke u asfiksuar me një shishe prej plastike. Familja e të ndjerit, pasi që kishte dyshime mbi hetim paraprak, ka kërkuar që ekspertë mjeko-ligjor të zgjedhur nga ata vetë të jenë të pranishëm gjatë ekspertizës. Sipas mendimit të tyre, vdekja e z. DEHARI Astrit është pasojë e një asfiksie mekanike traumatike për shkak të një obstruksioni të rrugëve ajrore interne, të shkaktuara nga një shtypje e madhe me një objekt me qëndrueshmëri të fortë.

Në këtë kontekst, një pako është drejtuar në Qendrën Universitare Romand të Mjekësisë Ligjore (CURML) me kërkesë që të ndërmerren të gjitha hetimet e pavarura të nevojshme për të hedhur dritë mbi vdekjen e z. DEHARI Astrit.

## I. PËRMBLEDHJE E ELEMENTEVE TË PROCEDURËS

### a. Kërkesë për asistencë juridike të dyanshme ndërkombëtare për çështjen penale të 05 shkurtit 2018

Një hetim është bërë nga “Basic Prosecution in Prizren”, në departamentin e Krimeve të Rënda (“Department of Serious Crimes”), që lidhet me “vdekjen e dyshimtë” të trupit të pajetë të z. DEHARI Astrit, i cili, më 05 nëntor 2016 disa minuta pas orës 15:00, është gjetur pavetëdije në qelinë A3 të katit të dytë të qendrës së paraburgimit në Prizren. Vdekja e tij është konstatuar në ora 15:55, të njëjtën ditë, në spitalin rajonal të Prizrenit.

Në këtë çështje nuk ka asnjë të dyshuar.

Në kapitullin e deklaratës së fakteve aktuale në kërkesë, përmendet se: “vdekja e z. DEHARI Astrit ka ndodhur në lokalet e qendrës së paraburgimit në Prizren më 05 nëntor 2016 gjatë kohës së drekës (ang. “lunch time”) të të burgosurve, pra ai nuk e ka marrë këtë racion (shënime të ekspertëve: *sipas informacionit policor të përfshirë në pjesën tjetër të procedurës, ai e ka marrë këtë racion*) dhe se ishte vetëm në qeli A3 në katin e dytë të qendrës. Pasi që përfundoi racioni, disa minuta pas orës 15:00, z. DEHARI Astrit është gjetur i pandjenja nga bashkë mbajtësit, i shtrirë mbi tokë në shpinë me një shishe prej plastike e mbushur përgjysmë me mjaltë, e vendosur thellë në gojë dhe fyte. Një ndihmëse ndihmë mjekësore emergjente i është bërë nga personeli i shërbimeve të qendrës së paraburgimit, pastaj z. DEHARI Astrit është dërguar në spitalin rajonal të Prizrenit, ku është konstatuar vdekja e tij rreth orës 15:55”

Në kapitullin që ka të bëjë me arsyet e dhëna për kërkesën e ndihmës ligjore, përmenden elementët e mëposhtme:

- Vendi i gjetjes së trupit (ang. “crime scene”) dhe kamerat e sigurisë të qendrës së paraburgimit janë ekzaminuar nga “Criminalistics Technique Unit” të policisë së Kosovës.
- Kamerat e sigurisë janë ekzaminuar a posteriori nga ekspertët e “Federal Criminalistics Entity of the Federal Ministry of Internal Affairs” të Republikës së Austrisë.
- Janë realizuar marrjet në pyetje të dëshmitarëve okularë dhe dëshmitarë tjerë,
- Materiali i sekuestruar në vendin e zbulimit të trupit është marrë dhe analizuar,
- Një analizë grafologjike të dorëshkrimeve të trupit të pajetë të z. DEHARI Astrit është kryer,
- Një ekzaminim i këtyre dorëshkrimeve është bërë nga “Institute of Forensic Psychiatry”,
- Ekzaminime serologjike dhe analizat e ADN-së janë bërë.

Pas analizës së kamerave të sigurisë, është konstatuar se dera e qelisë A3 ishte e mbyllur në vazhdimësi gjatë racionit dhe se dritarja e qelisë A3, e vendosur në 8 metra lartësi mbi tokë (*shënim i ekspertëve: jashtë*) ishte e mbyllur nga jashtë me një grilë metalike të paprekur.

Sipas konkluzioneve të departamentit të mjekësisë ligjore (DML) në Prishtinë, lëndimet e konstatuara mbi z. DEHARI në nivelin e qafës dhe të dorës kanë qenë të vetë-goditura nga

aspektet e ngurrimit, me ndihmën e një brisku rroje. Gjithashtu z. DEHARI kishte shkaktuar vetë asfiksi dhe asfiksionë e vetë me një shishe prej plastike që kishte rezultuar në vdekjen e tij.

Familja e të ndjerit, pasi që kishte dyshime për profesionalizmin dhe objektivitetin e zyrtarëve që kishin udhëhequr hetimin paraprak, kanë kërkuar që ekspertë mjeko-ligjor të zgjedhur nga ata të jenë të pranishëm gjatë autopsisë. Sipas mendimit të tyre, vdekja e z. DEHARI Astrit është pasojë e një asfiksie mekanike traumatike për shkak të një obstrukcioni të rrugëve ajrore interne, të shkaktuara nga një shtypje e madhe me një objekt me qëndrueshmëri të fortë. Ata e klasifikojnë këtë asfiksi si të dhunshme me bllokim komplet të rrugëve ajrore dhe një vdekje e shpejtë. Për ndryshe, ata përfundojnë për lëndime të simuluar (ang. "simulation damage") dhe lëndime në mbrojtje (ang. "self-defense signs") të dukshme mbi trupin e z. DEHARI.

**b. Raporti (oficial memorandum") që përmbledh hetimet e Drejtorisë së Policisë rajonale të Prizrenit, pa datë**

Policia e Kosovës është paralajmëruar më 05 nëntor 2016 rreth orës 15:25 se një i mbajtur në qendrën e paraburgimit në Prizren ishte i pavetëdijshëm. Rreth 15:55, policia është lajmëruar për vdekjen e të paraburgosurit në spitalin rajonal të Prizrenit. Me qëllim për të siguruar vendin e ngjarjes, hetuesit e "Regional Investigattion Sector in Prizren" janë shkuar në vendin e ngjarjes rreth orës 16:20. Rreth orës 19:00 atyre u janë bashkëngjitur hetuesit e Directorate of Investigattion of Serious Crimes in Pristina". Të mbajturit e qelisë A3 e vendosur në katin e dytë të qendrës së paraburgimit në Prizren, ishin : z. DEHARI Astrit, z. GASHI Adonis, z. MAKOLLI Naser dhe z. LASKI Frrok.

Z. DEHARI Astrit, ishte arrestuar nga policia e Kosovës më 30 gusht 2016 bashkë me aktivistë tjerë të lëvizjes vetëvendosjes (*shënim i ekspertëve : parti politike*) "LËVIZJA VETVENDOSJE" i dyshuar se kishte kryer një sulm terrorist kundër kuvendit të Kosovës më 04 gusht 2016.

Në 2014, i vëllai i z. DEHARI Astrit, z. DEHARI Arbnor, edhe ai aktivist i "LËVIZJA VETVENDOSJE" kishte bërë vetëvrasje në Prishtinë duke u hedhur nga dritarja e banesës, e vendosur në katin e 6<sup>të</sup>.

Z. DEHARI kishte 9 raste kriminale dhe 4 vepra kriminale në bazën e të dhënave të policisë së Kosovës.

Më 05 nëntor 2016 në ora 11:58, racioni i drekës u ishte shërbyer të mbajturve, nënkuptuar këtu z. DEHARI. Në ora 12:43, të gjithë të mbajturit e qelisë A3 kishin shkuar në dush dhe janë kthyer në qeli. Në ora 13:53 të mbajturit kishin mundësi të shkonin në shëtitje. Nga qelia A3, fillimisht dy persona kanë dalë, pastaj i treti në veshje sportive dhe një kasketë. Gardiani (ang. "correctional officer") i është afruar qelisë A3 dhe e ka ngritur dorën. Sipas policisë, ky është shenja (ang. "it's understood") se personi i katër z. DEHARI, nuk dëshironte të shkojë në shëtitje. Roja menjëherë e ka mbyllë qelinë dhe me të mbajturit tjerë është nisur në drejtim të vendit të shëtitjes. Z. DEHARI e kishte informuar njërin nga të mbajturit (Z. MAKOLLI Naser) se nuk dëshironte të shkojë në shëtitje pasi që nuk ndjehej mirë. Kur të mbajturit e qelisë A3 u kthyen nga shëtitja, e kanë hapur derën e qelisë dhe e kanë gjetur z. DEHARI me një shishe në

gojë. Ata menjëherë kanë kërkuar ndihmë nga gardiani. Ky i fundit i ka ofruar ndihmën e parë emergjente dhe e ka informuar shërbimin e shëndetësisë të qendrës.

Sipas policisë, informatat e ofruara nga dëshmitarët bënin të ditur se z. DEHARI nuk dëshironte të shkojë në shëtitje pasi që kishte marrë një dush më herët dhe se kishte të ftohtë. Ai saktësisht kishte thënë se nuk ndjehej mirë, pa dhënë informata tjera.

Policia zbuloni sekuencën e ngjarjeve në vazhdim në regjistrimin video:

- 12:58 : Qelia A3 hapet për orën e racionit dhe 4 të mbajtur (pra edhe z. DEHARI) dalin nga qelia dhe marrin ushqimin e tyre.
- 13:41 : qelia A3 është e mbyllur.
- 13:50: të mbajturit dalin nga qelia për të shkuar në dush.
- 14:09: të mbajturit kthehen në qeli A3.
- 14:11 (06") : Një i mbajtur (*shënim i ekspertëve: identiteti nuk përmendet*) del nga qelia A3 në korridor, shikon dhe kthehet sërish në qeli.
- 14: 11(40"): gardiani e kontrollon qelinë A3, shikon a janë të mbajturit në qeli dhe e mbyll derën.
- 14:52 (00") : gardiani e hapë derën e qelisë A3.
- 14:52 (37") : dy të mbajtur dalin nga qelia A3.
- 14:52 (53") : një i mbajtur del nga qelia me një kasketë dhe veshje sportive.
- 14:53 (02") : "Të gjithë të mbajturit braktisin korridorin për shëtitje".
- 14:53 (22") : gardiani i afrohet qelisë A3 ngrit dorën sikur të përshëndeste dhe e mbyll derën (z. DEHARI Astrit nuk ka dalë nga qelia dhe duket se gardiani e përshëndet dhe e mbyll derën) [*shënim i ekspertëve: brenda kllapave në tekst*].
- 15: 53 (17") : qelia a3 hapet, njëri nga të mbajturit kthehet në qeli, ndërsa një tjetër ndalet në derë dhe flet me një të mbajtur tjetër.
- 15:53 (25") : janë shënuar disa "reagime" dy të mbajtur diskutojnë në derën e qelisë dhe të cilët z kthyen në qeli.
- 15:53 (28") : Vërehen reagime të të mbajturve që kërkojnë ndihmë.
- 15:53 (51") : gardiani arrin në qeliA3.
- 15:55 : tekniku mjekësor erdhi në korridor.
- 15:56 : tekniku mjekësor del nga qelia A3.
- 15:56 : një i mbajtur hyn në qelinë A3 me një shishe me ujë.

**c. Raportin e "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" të 30 nëntorit 2016 që ka të bëjë me tri regjistrime video,**

Një mision i ekspertizës ishte udhëhequr nga "Agjencisë Kosovare të Forenzikës" për të ekzaminuar tri regjistrimet vide (DVD#1 HKVISION seria nr. 501062556 04; DVD#1 HKVISION seria nr. 522994844; DVD#1 HKVISION seria nr. 501062557 04) me qëllim të përcaktimit se a kishte intervenime apo interferenca mbi material. Konkluzionet e këtij raporti janë se ky institucion nuk disponon me pajisje dhe ekspertë të nevojshëm për këtë lloj veprimtarie.

**d. Raportin e “Federal Entity of Criminology” të Ministrisë së Punëve të Brendshme austriake të 23 gushtit 2017**

Një mision i ekspertizës ishte dërguar në “Federal Entity of Criminology” të Ministrisë së Punëve të Brendshme austriake me qëllim të verifikimit se mos kishte manipulim cilido qoftë në nivelin e tri regjistrimeve video [shënim i ekspertëve: ne kuptuam se ka të bëjë me regjistrime që nuk kanë pasur mundësi të analizohen nga “Agjencisë Kosovare të Forenzikës”]. Raporti i këtij institucioni saktëson se asnjë element nuk hedh në shesh manipulimin e videos.

**e. Raportin daktiloskopik të “Agjencisë Kosovare të Forenzikës” të 18 nëntorit 2016**

Një mision i ekspertizës ishte udhëhequr nga “Agjencisë Kosovare të Forenzikës” për të ekzaminuar provat material (ang. “evidence”) dhe për të përcaktuar praninë e gjurmëve digjitale mbi këto të fundit. Sipas këtij raporti, ekzistojnë gjurmë “linjave papilare” mbi pjesën e sipërme të shishes nga plastika (evidenca #5) dhe në sipërfaqen e brendshme dhe të jashtme mbi shishen e markës “SINBO” (evidenca #6). Gjurmë fragmentare të “linjave papilare” në veçanti ishin të dukshme mbi një orë me mbishkrim “Mowatch” (evidenca #19). Megjithatë këto gjurmë të “linjave papilare” nuk kishin karakteristika individuale (anatomike) të mjaftueshme për një “punë plotësuese” (ang. “further work”) [shënime të ekspertëve: ne konkludojmë nga këto rezultate se gjurmët digjitale të gjetura mbi këto tri objekte ishin të papërdorshme].

**f. Raportin e ekspertizës gjenetike të “Agjencisë Kosovare të Forenzikës” të 18 nëntorit 2016,**

Një mision i ekspertizës ishte udhëhequr nga “Agjencisë Kosovare të Forenzikës” për të nxjerrë profilet e ADN-ve të të gjitha provave materiale (ang. “evidence”) dhe t’i krahasojë me profilin ADN-së së z. DEHARI Astrit (#A.D). Sipas këtij raporti, profilet e ADN-ve të ngjashme me atë të z. DEHARI janë nxjerrë në pah tek provat materiale në vazhdim: një pambuk (ang. “swab”- #3), një peshqir i gjelbër (#4), një peshqir gri-jeshile (#4.1), një shishe plastike (#5), një shishe e markës “SINBO” (#6), një sapun ngj. trëndafili (#7), pambuktët (#9), një pambuk (#11), një sfungjer i rrethuar me një këmishë (#12), një paketim plastike me mbishkrim “Gillette” – MACH3”, një brisk rroje (#13), një stilolaps me mbishkrim Ecolab (#14) një pambuk (#15). Asnjë përzierje gjurmësh nuk është identifikuar në bartësit e ndryshëm të analizuar.

**g. Raportin e ekspertizës gjenetike të “Agjencisë Kosovare të Forenzikës” të 25 nëntorit 2016,**

Një mision i ekspertizës ishte udhëhequr nga “Agjencisë Kosovare të Forenzikës” për të nxjerrë profilet e ADN-ve të rrobave të bartura nga z. DEHARI Astrit në momentin e vdekjes së tij dhe të krahasohen me profilin e ADN-së së z. DEHARI Astrit (#A.D) Sipas këtij raporti, profilet e ADN-ve të ngjashme me atë të z. DEHARI janë nxjerrë në pah mbi rrobat : një palë pantallona



sporti (ang. A pair of lower parts of sport clothes - #A1), një “marcel” e bardhë (ang. under shirt - #A3) dhe brekë (ang. underpants - #A4). Asnjë përzierje gjurmësh nuk është identifikuar në bartësit e ndryshëm të analizuar. Raportin e ekspertizës së grafologjisë të “Agjencisë Kosovare të Forenzikës” të 06 dhjetor 2016,

**h. Raportin e ekspertizës së grafologjisë të “Agjencisë Kosovare të Forenzikës” të 06 dhjetor 2016,**

Një mision i ekspertizës ishte udhëhequr nga “Agjencisë Kosovare të Forenzikës” për të krahasuar shkrimin e pranishëm në dorëshkrimet e marrë në qelinë A3 të qendrës së paraburgimit në Prizren (evidenca#22 dhe evidenca#G6) me shkrimin e të ndjerit z. DEHARI Astrit (materialin e njohur të z. DEHARI – evidenca #Astrit Dehari dhe#Fakulteti i Mjekësisë). Sipas këtij raporti dokumentet e analizuara paraqesin një shkrim që korrespondon me atë të z. DEHARI Astrit.

**i. Raporti i ekspertizës psikiatrike të Institutit të Psikiatrisë forenzike të Kosovës të 16 dhjetorit 2016,**

Një mision i ekspertizës i ishte dërguar Institutit të psikiatrisë forenzike të Kosovës, me qëllim të vlerësimit të gjendjes emocionale dhe psikologjike të të ndjerit z. DEHARI Astrit, duke u nisur nga këto shkrime. Ekipi i ekspertëve përbëhej nga këta anëtarë : Dr. Fahri Drevinja, neuropsikiatër; Dr. Ajert Bunjaku, psikiatër; Dr. Arife Veselaj, psikologe dhe Dr. Sc Gani Halilaj; neuropsikiatër, drejtor i institutit. Përfundimet e raportit janë në vazhdim:

- Nuk kishte nocion krize emocionale të rëndë as edhe shkëputje të mëdha (ang. breakdown) emocionale,
- Nuk kishte shenja, të planit përgatitor për një “vizion negativ” (ang. “negative-sense” vision) në aspektin kriminal,
- Kishte një gjendje emocionale që ndryshonte kohë pas kohe në funksion të perceptimeve, të ditës, të situatës politike, të pritjeve, të frikës së kualifikimeve të shkeljeve dhe për të cilat, nganjëherë ai shprehte trishtim, pasiguri dhe një pesimizëm.
- Disa nga shkrimet reflektonin një gjendje emocionale sensibile dhe skeptike, që korrespondonte ndoshta me një gjendje emocionalisht të brishtë.

## j. PROCESVERBALET E AUDIENCAVE

PV e audiencës së z. MAKOLLI Naser i 05 nëntorit 2016 – i mbajtur në të njëjtën qeli me z. DEHARI Astrit.

Z. MAKOLLI tregon se gjendet në qendrën e paraburgimit në Prizren që prej 9 muajsh dhe ka një muaj e gjysmë që z. DEHARI ka ardhur në këtë qeli (A3). Në qeli, ishin katër të mbajtur: ai, Astriti, Frrok Leski dhe Adonis GASHI.

Z. MAKOLLI përshkruan se gjatë kësaj kohe sa ka kaluar me te, z. DEHARI, ishte gjithnjë i lumtur, i qetë, nuk paraqiste asnjë çrregullim, asnjë frikë as shqetësim dhe asnjëherë nuk e ka përmend se do të mund t'i bëj diçka vetvetes.

Z. MAKOLLI tregon se më 05 nëntor 2016, si çdo ditë, në ora 14:00 deri në 15:00, ata kanë dalë në shëtitje, por z. DEHARI ka qëndruar në qeli duke thënë se nuk ndjehej mirë. Kur ata janë kthyer nga shëtitja, rreth orës 15:00 ata e kanë gjetur të shtrirë mbi tokë, inertë. Ai kishte në gojë një shishe mjalti prej plastike. Ata menjëherë e kanë thirrë mjekun dhe janë informuar se kushte një puls. Ai shton se nuk ka parë gjake pranë trupit të tij dhe se vetëm ka parë plagë në njërin nga duart e tij. Z. MAKOLLI saktëson se nuk kishte brisk rroje as thikë në qeli.

PV e audiencës së z. MAKOLLI Naser i 09 nëntorit 2016 – i mbajtur në të njëjtën qeli me z. DEHARI Astrit.

Z. MAKOLLI tregon se ishte më i afërt me z. DEHARIN se sa me tjerët e mbajtur. Ai tha se z. DEHARI kishte sjellje të mira, se ishte një djalosh i artë, ishte komunikativ, ai luante letra dhe tregonte barçoleta. Më 05 nëntor 2016 nuk ishte i mërzhitur dhe nuk kishte sjellje të pazakonshme.

Z. MAKOLLI tregon se nuk e di se a ka ngrënë z. DEHARI në gjatë racionit.

Z. MAKOLLI tregon se pasi që janë kthyer nga dushi, ata janë veshur dhe kanë diskutuar si zakonisht. Rreth orës 14:00 gardiani erdhi që t'u thotë se duhet të dalin. Tre mbajtësit tjerë kanë dalë dhe z. DEHARI ka thënë "unë nuk po vij sepse kam dhimbje koke dhe nuk po ndihem mirë". Z. MAKOLLI tregon se në vigjilje, z. DEHARI nuk ka dalë në shëtitje. Kur janë kthyer nga shëtitja, rreth orës 15:00, ai ishte i pari që hapi derën dhe e ka parë z. DEHARI të shtrirë në shpinë me duar të hapura, me shishen e mjaltit prej plastike në gojë. Kemi të bëjmë me një shishe që mund të blihet në kantinë. Në fillim ai ka besuar z. DEHARI bënte shaka, dhe përfundimisht, ai e ka kuptuar se ishte diç serioze dhe i ka parë gërvishtjet mbi dorën e tij të majtë. Menjëherë ka dalë nga qelia dhe ka kërkuar ndihmë. Atij nuk i kujtohet kush e ka largua shishen. Mjeku ka ardhur pas kërkesës së gardianit (Daut) [*shënim i ekspertëve: Z. KASTRAT*] dhe ka thënë se z. DEHARI kishte puls ende.

Z. MAKOLLI thotë se z. DEHARI është rruar gjatë dushit por nuk është prerë. Brisqet e rrojës na ofrohen nga gardianët dhe duhet që tua dorëzojmë pas dushit. Ai saktëson se ndodh nganjëherë për ta fshehur dhe të ruhen brisqet e rrojës në qeli.

Z. MAKOLLI shtoi se dy javë më herët, z. DEHARI i kërkoi atij numrin e të afërmeve të tij duke kërkuar që do t'u telefonojë nëse ndodh diçka. Ai shton se z. DEHARI nuk kishte presion nga askush, qoftë edhe nga gardianët.

**PV e audiencës së z. MAKOLLI Naser i 18 nëntorit 2016 – i mbajtur në të njëjtën qeli me z. DEHARI Astrit.**

Z. MAKOLLI mbahej në qelinë A3 krahu A të qendrës së paraburgimit të Prizrenit që prej 8 muajsh. Z. DEHARI ishte në qelinë e njëjtë që prej 2 muajsh dhe që prej një muaji, kishin edhe dy të mbajtur tjerë. Z. LASKI dhe Z. GASHI.

Sa u përket ngjarjeve të 05 nëntorit 2016, z. MAKOLLI tregon se pas drekës, gardiani i ka hapur dyert dhe ka thënë se duhet të shkojnë për të bërë dush. Të mbajturit i kanë lëshuar qelitë e tyre dhe janë vendosur në tualetet e krahut C të qendrës së paraburgimit, të shoqëruar nga gardiani, z. KASTRATI. Pas dushit, ata sërish janë kthyer në qelitë e tyre për t'u ndërruar dhe pas 1 ore më vonë, rreth orës 14:00 gardiani ka ardhur dhe e ka hapur derën e qelisë në mënyrë që dalim në shëtitje. Në momentin e daljes njëri nga të mbajturit e ka pyetur z. DEHARI se a do të vijë dhe ky i fundit iu ka përgjigjur se nuk dëshironte të dalë me ta sepse kishte dhimbje koke, nuk ndjehej mirë dhe në mes tjerash ai parashikonte të bënte një telefonatë. Të mbajturit tjera kanë dalë për të shëtitur dhe janë kthyer në qeli rreth orës 15:00. Z. MAKOLLI ishte i pari që hyri në qeli, të tjerët ishin prapa tij. Ai e ka parë z. DEHARI të shtrirë mbi tokë në shpinë, kokën e kthyer lehtësisht majtas, me një shishe [shënim i ekspertëve: pa saktësi tjera]. Ai ishte i lagur në pjesën e prapme të trupi të tij. Në këtë moment z. MAKOLLI ka thirrur: “shpejt thirreni mjekun ose kë do”. Gardiani “Daut” [shënim i ekspertëve: Z. KASTRATI] ka ardhur menjëherë dhe posa e pa z. DEHARI Astrit në këtë gjendje, ai i urdhëroi të mbajturit të dalin shpejt nga dhoma pastaj ai ka hyrë për ta vërtetuar gjendjen e z. DEHARI, e ka prekur faqen e tij dhe ia mori pulsën. Pastaj, ai i urdhëroi ata ta transferojnë z. DEHARI në sallën mjekësore të qendrës së paraburgimit sepse ende kishte puls. z. DEHARI kishte shkruar në bllokun e adresave të z. MAKOLLI, një seri numrash të telefonit të anëtarëve të familjes së tij dhe miqve të tij. Arsyeja për këtë ishte se z. DEHARI dëshironte që z. MAKOLLI ta njoftonte rrethin e tij në rast të transferimit nga burgu për hetime nga ana e policisë ose të Ministrisë publike. Duhej të lajmërohej edhe avokati i tij.

**PV e audiencës së z. MAKOLLI Naser i 02 dhjetor 2016 – i mbajtur në të njëjtën qeli me z. DEHARI Astrit.**

Në momentin e dëgjimit, z. MAKOLLI deklaroi se në qelinë A3, ai kishte fshehur një telefon që përdorte ai vetë dhe z. GASHI Adonis dhe z. DEHARI Astrit. Por z. DEHARI Astrit kurrë nuk e kishte përdorur këtë telefon.

**PV e audiencës së z. LASKI Frrok i 05 nëntorit 2016 – i mbajtur në të njëjtën qeli me z. DEHARI Astrit.**

Z. LASKI deklaroi se ka qenë i mbajtur në qelinë A3 gjatë dy javëve. Gjatë kësaj kohe, ai ka pasur mundësi ta njohë z. DEHARI sipas tij ai nuk ka qenë një person i qetë dhe i lumtur. Gjatë kësaj kohe, ai nuk ka treguar asnjë shenjë që do të mund të bënin të mendohet se mund t'i bënte veti keq. Kemi të bëjmë me një intelektual i cili kishte lidhje të mira me të gjithë. Ai nuk zihej me askënd, përfshirë edhe gardianët, me të cilët kishte raporte të mira. Më 05 nëntor 2016, z. DEHARI nuk ka dalë ndemjet orës 14:00 dhe 15:00 pasi që nuk ndihej mirë. Në momentin e kthimit të tyre në qeli, me tu hapur dera e qelisë, z. LASKI ka konstatuar se z. DEHARI pushonte i shtrirë mbi tokë dhe se kishte një shishe të vogël mjalti në gojë. Shishja ishte futur thellë në nivelin e fytit. Ai menjëherë e ka thirrur gardianin "Daut" [shënim i ekspertëve: z. KASTRATI] i cili erdhi. Personi mjekësor i qendrës është informuar dhe pohoi se z. DEHARI kishte një puls dhe se do të transferohet në mënyrë që të gëzon një trajtim. Ai ka vërejtur se z. DEHARI kishte një prerje pranë dorës së majtë. Nuk kishte gjak në vendin e ngjarjes apo mbi trup dhe se ai nuk ka vërejtur ndonjë instrument që do ta lëndonte pranë trupit. Z. DEHARI kishte marrëdhënie shumë të mira edhe me familjen e tij.

**PV e audiencës së z. LASKI Frrok i 10 nëntorit 2016 – i mbajtur në të njëjtën qeli me z. DEHARI Astrit.**

Z. LASKI i kujtohet se pasi që janë kthyer nga dushi, nuk ishte askush në qeli. Z. DEHARI shëtitej dhe këndonte në qeli. Z. LASKI ka dalë me Adonisin dhe Naserin në ora 14:00 dhe është kthyer në ora 15:00. Për ndryshe, Astriti ka kërkuar të qëndrojë në qeli sepse nuk ndjehej mirë. Z. LASKI nuk e ka dëgjuar të thoshte kështu, por këtë shpjegim e ka dëgjuar nga të mbajturit tjerë. Gandiani e ka mbyll derën e qelisë. Ai shton se dera e qelisë nuk mund të hapet nga brenda por vetëm nga jashtë. Pas një ore shëtitejeje, tre të mbajturit janë drejtuar për në qeli. Ky apo Naseri e kanë hapur derën. Kur ka hyrë ai ka vërejtur Astritin shtrirë mbi tokë në shpinë me duar të hapura, ai ishte i lagur në nivelin gjenital, dora e tij e majtë kishte gërvishtje, mangët e tij ishin përvjelë deri në gjysmën e dorës dhe ora ishte pranë kyçit të dorës. Ndër të tjera, ai ka konstatuar se Astriti kishte një shishe prej plastike e mbushur për gjysmë me mjaltë, në gojë. Shishja kishte një kapak të verdhë. "Dauti" (gardiani) e ka tërhequr shishen nga goja e Astritit. Sipas intervenimeve të para të teknikëve mjekësorë, z. DEHARI tregonte ende shenja jete. Sa i përket këtij, ai nuk e di se tregonte shenja jete por ai ka vërejtur se ishte i zbehtë. Ai nuk di si ta përshkruajë situatën ndryshe. Astriti ka qenë një person i qetë dhe i rezervuar, ai shkruante letra, lexonte romane, gazeta, ishte i vetmi ë shkruante letra në qeli. Ai ishte një person serioz, por ishte shumë komunikativ, i gatshëm për të ndihmuar. Ai e ka përmendur të vëllain vetëm njëherë, duke thënë se ishte i vdekur.

Në pyetjen se a e dinte se z. DEHARI vuante nga ndonjë formë e presionit nga kush do, z. LASKI u përgjigj jo, vetëm një ditë kur kishte ndodhur një protestë dhe se emri i Astritit ishte përmendur gjatë protestës e kemi parë se lëvizte pa pushim në qeli. Gjatë natës së 04 nëntorit 2016, ai ishte zgjuar dhe e kishte vërejtur Astritin që ishte fjetur me këpuca. Dhjetë minuta më vonë, e dëgjoi Astritin se u zgjua, zbriti nga krevati dhe shikoi në sirtar. Këtë e bëri tri a katër herë. Në një moment i kishte thënë të shtrihej për të fjetur. Pastaj ai i hoqi këpucët dhe u shtri për të fjetur rreth orës 2 ose 3 të mëngjesit.

**PV e audiencës së z. GASHI Adonis i 05 nëntorit 2016 – i mbajtur në të njëjtën qeli me z. DEHARI Astrit.**

Z. GASHI ishte në të njëjtën qeli me z. DEHARI Astrit që një javë e gjysmë. Sipas tij z. DEHARI ishte një tip i mbyllur, fjalëpakë, shumë i qetë, që asnjëherë nuk ka treguar shenja që shprehnin vullnetin për të bërë keq. Pas kthimit nga shëtitja, rreth orës 15:00 e ka parë Astritin të shtrirë mbi tokë në qeli. Pjesa e djathtë e qafës së tij ishte e skuqur dhe ishte i lagur në nivelin e organeve gjenitale. Ai nuk ka vërejtur pranë trupit të tij asnjë objekt me të cilin mund të shkaktoheshin plagë, as gjak në vendin e ngjarjes. Ai e dinte se Astriti ishte një aktivist politik (grupi politik LVV). Ai nuk ankohe për asgjë (ang. “he did not complain of anything”).

**PV e audiencës së z. GASHI Adonis i 10 nëntorit 2016 – i mbajtur në të njëjtën qeli me z. DEHARI Astrit.**

Z. GASHI deklaroi se kur ai është kthyer në qeli pas shëtitjes, e ka parë Astritin mbi tokë, kokën e ngritur pak lartë e duart e larguara përgjysmë. Ai konstaton se kishte një plagë në nivelin e qafës, në anën e djathtë. Në mes tjerash, pohon se ai ishte i lagur në pjesët gjenitale dhe se kishte një erë të pakëndshme. Qelia ishte e çrregulluar, me sirtar të hapur, një peshqir i gjelbër mbi tokë si disa nga fletoret e tyre [*shënim i ekspertëve: për z. Gashi*]. Posa e ka parë Astritin në këtë situatë, ai e ka thirrë gardianin i cili ka mbërritur për disa sekonda dhe e ka larguar shishen e mjaltit nga goja e Astritit. Kur e ka bërë këtë gjest, trupi i Astritit ka lëvizur. Në këtë kohë, teknikja medicinale ka mbërritur në qeli dhe ka urdhëruar ta shijnë në infirmieri, çfarë edhe kanë bërë të mbajturit. Këmisha e Astritit është hequr dhe ai pohon se gjoksi i tij ishte i kuq. Sirtari i tij gjendje mbi tokë dhe ai konstaton se efektet personale ishin aty. Z. GASHI tregon se ai vetë e kishte blerë kavanozin e mjaltit javën e ardhjes së tij në qeli pasi që ishte me grip. E kishte konsumuar rreth 30%. Sjellja e Astritit ishte e mirë, si me të burgosurit ashtu edhe me gardianët. Gjatë kohës së tij të lirë, ai lexonte libra, shkruante çdo mbrëmje, luante letra dhe shpesh këndonte.

Më 05 nëntor 2016, Astriti ishte mirë, sikur çdo ditë tjetër. Ai e kishte pastruar tualetin dhe z. GASHI i kujtohet shumë mirë se Astriti kishte kënduar një kohë të gjatë nën dush. Asgjë të veçantë nuk kishte hetuar tek ai. Astriti ishte gjallë kur ka dalë ai nga qelia. Ai ishte vetëm në tokë bënte diçka por Gashi nuk e vërejtë se çka. Kur u nxor shishja nga goja e tij, kishte gjak në

gojën e tij. Z. Gashi nuk mendon se dikush tjetër e ka mbytur, duke parë se siguria është shumë e latredhë se askush nuk mund ta bënte këtë. Ai është i bindur se ka bërë vetëvrasje.

**PV e audiencës së z. KASTRATI Daut – gardian i burgut- më 05 nëntorit 2016**

Z. KASTRATI ishte i caktuar në krahun A – 7/19 nga ora 07:00 deri në 19:00. Në ora 14 ai ka shkuar në qeli A3 për shëtitjen e pasdites. Kur e hapi derën, z. DEHARI i kërkoi nëse mund të qëndrojë në qeli sepse dëshironte ta rregullonte dhe se kishte pak ftohtë.

Në ora 15:05, të mbajturit e krahut A u kthyen nga shëtitje. Të bashkë mbajturit e z. DEHARI vetë e tre të mbajtur tjerë kanë “reaguar” dhe kanë kërkuar ndihmë. Z. KASTRATI i ka dhënë ndihmën e parë duke e hequr shishen e plastikës rreth 5 cm nga goja e tij. Pasi që e ka heq shishen, ai ka konstatuar se z. DEHARI kishte ende puls. Pastaj ndihmësit kanë ardhur në qeli.

**PV e audiencës së z. KASTRATI Daut – gardian i burgut- më 05 nëntorit 2016**

Z. KASTRATI raporton se më 05 nëntor 2016, ai ia ka dhënë një brisk rroje z. DEHARI dhe se ky i fundit e ka kthyer në vendin e zakonshëm pasi që është rruar. Z. KASTRATI saktëson se z. DEHARI nuk kishte probleme me të mbajturit tjerë, si dhe me askënd aty. Sjellja e tij ishte shumë e mirë. Ai ishte shumë i edukuar dhe i sjellshëm me të gjithë. Z. KASTRATI mendon se stilolapsi i lidhur me lidhësen e këpucëve, i gjetur në tualet, ishte përdorur për të mbyllur derën e tualetit e cila nganjëherë nuk mbyllet mirë. Kur të mbajturit tjerë janë kthyer nga shëtitja, z. DEHARI ishte gjallë, në qelinë e tij vetëm. Një tjetër i mbajtur nuk ka dalë në shëtitje atë ditë, z. MAZREKU Istref, i qelisë A2. Pasi që e ka tërhequr shishen e plastikës nga goja e z. DEHARI, ai ka konstatuar se goja e tij lëvizte dhe se ajri dilte nga goja e tij. Sipas z. KASTRATI, shishja ishte futur në gojë nga fundi i shishes (ang. “from the boton of the bottle”). Ai pohon se nuk i kujtohet se ka pasur gjak në qeli.

**PV e audiencës së z. MAZREKU Istref i 09 nëntorit 2016 – i mbajtur në qelinë A2 të qendrës së paraburgimit.**

Z. MAZREKU mbahej në qelinë A2 dhe gjendej në qeli gjatë kohës së shëtitjes pasi që nuk ndihej mirë. Gjatë kësaj kohe, ai gjendej vetëm në qelinë e tij, gjysmë i fjetur. Por pas përfundimit të shëtitjes rreth 10 minuta më herët pasi që të tjerët të kthehen, ai ka dëgjuar dy apo tri zhurma të lehta, pa mundur të tregojë se prej nga vinin këto zhurma.

**PV e audiencës së z. ALLAKAJ Luz i 10 nëntorit 2016 – i mbajtur në qelinë A6 të qendrës së paraburgimit.**

Në momentin ardhjes nga qelitet, z. ALLAKAJ mbahej në qelinë A6. Ai shpjegon se të gjithë ishin grumbulluar tek dera e qelisë së Astritit dhe se ai e ka parë Astritin shtrirë në shpinë, duart

e hapura me një shishe mjalti në gojë. Shishja ishte futur shumë thellë në gojën e tij (më shumë se gjysma dhe ndër tjera ai ka vërejtur një cikatricë në anën e djathtë të qafës. Ai ishte i lagur tek organet gjentiale. Ai u ka ndihmuar për ta bartur trupin e Astritit në infirmieri. Ai nuk di të thotë se a ishte gjallë në këtë moment. Ai ishte pak i errët (angl. "blackened"). Z. ALLAKAJ mendon se Astriti e ka bërë vetë tërë këtë.

**PV e audiencës së z. BAJRAMI Almir i 13 nëntorit 2016 – teknik mjekësor në qendrën e paraburgimit.**

Z. BAJRAMI është teknik i mjekësisë. Më 05 nëntor 2016, rreth orës 15:05, ata kanë pranuar një thirrje nga qendra e paraburgimit me informimin se dikush kishte vdekur në qendër. Ekipi i tij ishte drejtohej nga Dr SINANI Fisnik. Në momentin e mbërritjes së tyre, trupi ishte i shtrirë mbi një krevat, mjeku ishte i pari që iu afrua dhe ai u kërkoi që ta vendosin trupin mbi tokë. Menjëherë pas kësaj, një akçes venoz u vendos në vend. Një kolegë e përgatiti adrenalinën. Mjeku urdhëroi të fillohet rianimacioni dhe u fillua me një intubacion. Gjatë rianimit, z. DEHARI ka nxjerrë ujë nga goja i cili është thithur nga ndihmësit. Ata rifilluan me rianimim dhe pas një kohe, mjeku ka urdhëruar të vendoset trupi mbi një barelë dhe të transportohet në spital.

Me të arritur në vendin e caktuar, mjeku e vendosi një pulsoksimetër mbi gishtin e pacientit pastaj e verifikoi bebëzat, pulsën dhe urdhëroi të vendoset mbi tokë dhe të rianimohet. Z. BAJRAMI shpjegon se teknikët nuk janë në gjendje të thonë se pacienti paraqiste shenja jete dhe propozoi tu shtrohet kjo pyetje mjekëve.

**PV e audiencës së zonj. KODRALIU Bukurie 09 nëntorit 2016 – infermiere në qendrën e paraburgimit.**

Zonj. KODRALIU është infermiere në qendrën e paraburgimit në Prizren, puna e saj përqendrohet në ofrimin e trajtimeve mjekësore për të mbajturit. Ajo është thirrur më 05 nëntor 2016 në ora 15:00. Kur ka mbërrit në qelinë A3 ajo e ka parë Astritin të shtrirë mbi tokë, kokën e kthyer pak në të majtë, këmbët afër derës së tualetit dhe duart e larguara. Kishte të vjella pranë tij. Ajo e ka verifikua pulsën e tij në qafë dhe ka konstatuar se ai kishte pulse dhe se merrte frymë. Pastaj, ajo ka thirrë ndihmën dhe i ka kërkuar ekipit ta transferojnë të burgosurin poshtë drejt ambulantes. Të burgosurit e kanë bartur Astritin drejt ambulancës, ku ajo ka filluar t'ia jep ndihmën e nevojshme. Në nivelin e qafës kishte një vijë shumë të hollë dhe pak gjak, sikur kur dikush pritet duke u rruar. Ai kishte një prerje të vogël në nivelin e dorës e cila mezi shihej. Ai ishte shumë i zbehtë.

**PV e audiencës së Dr. SINANI Fisnik i 13 nëntorit 2016 – mjek**

Dr. SINANI deklaron se tekniku mjekësor, z. BAJRAMI ka pranuar një thirrje telefonike nga qendra e paraburgimit në Prizren se një vetë vrasje kishte ndodhur dhe se një ambulancë ishte e

nevojshme. Me të mbërritur në qendrën e paraburgimit në ora 15:00, personi ishte i shtrirë mbi një krevat. Ai ishte cianotik. Bebëzat ishin të zgjeruara. Ai nuk kishte puls periferik sipas informatave të oksimetrit. Ai nuk kishte as puls qendror. Dr. SINANI ka kërkuar lëndime mbi trupin e tij, në dritën e informacioneve të marrë që referonin për vetëvrasje. Në nivelin e kyçit të majtë (ang. "on the left hand, dhe bracolët part") [shënime të ekspertëve: që ne e interpretojmë si kyç], kishte një prerje të thatë sipërfaqësore. Një plagë sigurisht që ishte e pranishme në nivelin e pjesës së djathtë të qafës, në formë të gërvishtjes me gjak të tharë. Dr. SINANI ka filluar reanimimin dhe i ka kërkuar Almirin të vendos një tub venoze për të injektuar solucion të NaCl. Gjatë reanimimit, z. DEHARI villte në vazhdimësi. Gjithnjë nuk kishte shenjë të pulsit në oksimetër. Ai ka bërë një injeksion të parë pastaj të dytin me adrenalinë. Ai e ka thithur pacientin në gojë dhe e ka intubuar për arsyet e cekura më lartë. Në rast se ai nuk ksohet shenja jete, si një puls apo një respirim, ai ka vendosur ta transferojë z. DEHARI në spital.

#### **PV e audiencës së z. ABDULLAHU Fadil 13 nëntorit 2016 – teknik medicinal.**

Z. ABDULLAHU deklaron se ka pranuar një thirrje nga qendra e paraburgimit rreth orës 15:05 për shkak të një vetëvrasjeje. Dr. Fisnik, Almir dhe një vullnetar Enis menjëherë kanë mbërrirë në infirmieri të qendrës së paraburgimit ata kanë mbërrirë rreth orës 15:08. Mjeku ka vendosur oksimetrin dhe ka konstatuar se nuk kishte shenja jete. Sipas udhëzimeve të mjekut z. ABDULLAHU i ka dhënë një dozë të parë adrenaline pastaj aminofilin (2x përgjysmë: bronkodilator) dhe prapë adrenalinë. Rianimimi ka vazhduar për disa minuta por pacienti nuk tregonte asnjë shenjë jete sipas mjekut. Ai kishte të prera me gjak në nivelin e kyçit dhe në anën e djathtë të qafës.

#### **k. Përshkrimi i vendi ku u zbulua trupi**

##### **Sipas raportit të Njësisë së Forenzikës së policisë të Kosovës të 10 nëntorit 2016:**

Qelia A3 gjendet në katin e dytë të qendrës së paraburgimit në krahun A. Në qeli gjendet një banjë.

Mbi dyshtemenë e qelisë, gjenden (ndër të tjera) këto elemente: gjurmët e evokuara të gjakut, një kosh i mbeturinave, një sfungjer i mbështjellë me një këmishë(majicë) të zezë ( e cila ishte përdorur si një pashqir, e lagur me një materie e cila mund të ishte jargë ose vjellje), një lidhëse e kaltër, peshqirë, një shishe plastike me gjurmë që evokonin gjak, një shishe, një sapun me gjurmë që evokonin gjak, sytha pambuku, një brisk rroje me gjurmë që evokonin gjak. Të varur për krevati gjendeshin objekte nga najloni që formonin një lloj litari.

Dera e tualetit ishte e hapur. Brenda, mbi tokë gjendej një stilograf që paraqiste gjurmë të kuqe që evokonin gjak, lidhur sigurisht në një lidhëse këpuçësh. Në tualet gjendej një lavaman metalik mbi të cilin gjurmë të kuqërremta, që tregonin gjak, ishin të dukshme. Përbrenda lavamanit,



kishte një pjesë metalike që dyshohej se ishte një brisk rroje me gjurmë të kuqërreme që tregonin gjak.

Sipas listës së provave (ang. "list of evidence") të Njësisë së Forenzikës së policisë së Kosovës, pa datë:

Në këtë listë, ne kemi vënë re elementët e mëposhtme:

- Një lidhëse këpucësh e kaltër e gjatë rreth 58 cm (#1)
- Një shishe plastike me një kapak të verdhë që përmbante lëng që evokonte mjaltë (#5)
- Një bokall të llojit të çajnikut me mbishkrim "SINBO" me një kabull elektrike e gjatë 90 cm (#6),
- Një sapun (ang. "soup" sic [shënim i ekspertëve: sigurisht gabim shtypi, ne e interpretojmë këtë fjalë si "saop" (#7), ngjyrë rozë-kuqe e mbuluar me një ngjyrë kafe që evokonte gjak (#7),
- Një brisk rroje me mbishkrim Gillette me 5 brisqe i mbuluar me gjurmë të kuqe që evokonte gjak (#13),
- Një stilolaps me mbishkrim ECOLAB i lidhur në një lidhës këpucësh me ngjyrë të katër (#14),
- Një objekt metalik që paraqiste një brisk rroje (#17),
- Dy "pjesë" najloni të rregulluara në formë të një litari, më e madhja prej 1 x 85 cm dhe e dyta prej 1 x 36 cm (#18),

**Sipas raportit të Njësisë Forenzike të policisë së Kosovës të 17 nëntorit 2016:**

Më 17 nëntor 2016, reaktivi "BLUESTAR" është përdorur në qelinë A3 të qendrës së paraburgimit të Prizrenit me qëllim që të vihen në pah gjurmët e gjakut. Gjurmët e gjakut ishin vënë në pah përbrenda lavamanit (këndi i drejtë), mbi tokë të tualetit (ang. "With" sic) një spagë e lidhur për dere (të banjës) në raftin e majës së dollapit të z. Naser MAKOLLI, mbi raftet e epërme prej plastike, në të kundërtën e tualetit dhe mbi tokë të qelisë (një pjesë nën krevet).

Me 17 nëntor 2016, fotografi [shënim i ekspertëve: fotografi që nuk janë dorëzuar në procedurë] të bashkëmbajtësve dhe të z. DEHARI janë bërë në dhomën e ambulancë së qendrës së paraburgimit të Prizrenit në prani të Bardhyl Shehut (shef i infermierisë) dhe Elmir Berishës (teknik mjekësor). Kemi të bëjmë me Naser MAKOLLIN (14:05), Frrok LASKUN (14:14) dhe Adonis GASHIN (14:23). Fotografitë janë bërë mbi njerëz lakuriq pa vënë në pah lëndime (ang. "injury"), gjurmë (ang. "trace") ose asnjë shenjë dyshimi (ang. "suspicious sign").

Me 17 nëntor 2016, një bllok shënimesh (ang. "notebook") sigurisht që i përkiste z. DEHARI është gjetur mbi tokë, afër krevatit të Naser MAKOLLIT.

Raporti i autopsisë së z. DEHARI Astrit i Institutit të mjekësisë ligjore të Kosovës (raporti nr. MA16-286) pa datë.

Autopsia e z. DEHARI Astrit, i lindur më 26 shkurt 1990, është kryer më 07 nëntor 2016 nga ora 15:05 (*shënim i ekspertëve: ora 23 e 10 minuta pas konstatimit të vdekjes*) nga tre mjek ligjor (koronar), që dihen Dr. Musa Gashi, Dr. Naim Haliti dhe Dr. Flutra Blakaj. Gjatë autopsisë, 19 persona tjerë janë listuar si të pranishëm, në veçanti tre ekspertë të rekrutuar nga familja e të ndjerit, Dr. Besim Latifaj (patolog nga Anglia), Dr. Besim Ymaj (mjek ligjor-Shqipëri) dhe Dr. Hatixhe Latifi (Kosovë).

Raporti i autopsisë përmban një paragraf mbi rrobat e të ndjerit elementët e të cilit ne i kemi shënuar në vijim:

- Trupi barte një xhaketë, këmbë me mangë të gjata, pantallona të ushtrimeve dhe një palë brekë,
- Në pjesën e djathtë të xhaketës, pran qafës, gjurmë të kuqe janë vënë në pah, që ngjajnë në gjak.

Raporti i autopsisë përmban një paragraf mbi kujdesin mjekësor të të ndjerit ne i kemi konsideruar këto elemente.

- Me të pranuar në spital më 5 nëntor 2019 në ora 15: 20, z. DEHARI nuk tregonte shenja jete. Ai ishte i pavetëdijshëm, pa puls, pa shtypje arteriale, me një cianozë të përgjithësuar dhe me bebëza të zgjeruara. Ai paraqiste në nivelin lateral cervical të djathtë, gërvishtje (ang. "scratches") në formë të zhvoshkjes (ang. "excoriation") të pranishme në veçanti në nivelin e dy nyjave. "R/C" [*shënim i ekspertëve: që ne e interpretojmë si që të jenë artikulacione radio-karpale*].
- Në ora 15:30, anesteziisti ka gjetur një pacient me pavetëdije, pa puls, pa tension dhe i intubuar,
- Një rianimim kardio-pulmonar tashmë ishte kryer është vazhduar me masazh kardiak dhe me ventilim. Pacienti ka qenë i defibrilizuar shumë herë dhe ai ka pranuar adrenalinë, bikarbonat, atropine dhe dopamine. Vdekja është deklaruar në ora 15:55, me diagnozë përfundimtare arrest kardiovaskular dhe vdekja.

Ne i kemi caktuar edhe elementët në vazhdim të ekzaminimit të jashtëm të trupit, të përfshirë në raport:

- Prania e një fashe, e vendosur rreth kokës, ndërmjet pjesës supero të mesme të kokës dhe mjekrës,
- Prania e një kompresë të lyer me gjak, në nivelin e regjionit latero- cervikale të djathtë e mbajtur me ngjitës,
- Prania e një fashe në nivelin e kyçit të majtë,

- Në nivelin e regjionit frontal superior të djathtë, pjesërisht i mbuluar me flokë, rreth 5,5cm mbi vetullën e djathtë, lëkura është e dëmtuar (ang. “wounded”) mbi kate zona, në një sipërfaqe prej rreth 4 cm të diametrit, në një mënyrë relativisht ovale, afër njëra tjetrës, secila ka një diametër ndërmjet 4 dhe 9 mm dhe ngjyrë e kuqe intensive. Lëndime, në karakteristikat e ngjashme, veçanërisht janë të pranishme në nivelin e anës së djathtë të qafës ( në afërsi të gërvishtjeve të përshkruara më lartë), të aspektit të parregullt, që ishin ndërmjet 3 dhe 7 mm të diametrit; dhe të pjesës së infero-medial dhe të parakrahut të majtë rreth 4 cm mbi gërvishtjet të përshkruara më herët, me orientim boshtor lehtësisht të anuara në boshtin e madh të krahut, në një sipërfaqe prej 40x4mm. Sipas interpretimeve të mjekëve ligjorë, këto lëndime është e mundur se janë shkaktuar gjatë transportimit të trupit, gjatë rianimit mjekësor ose përmes “konvulsioneve” që shoqërojnë obstrukcionin e rrugëve ajror gjatë kontaktit me objektin e “skenës së krimin”.
- Në nivelin e syve “scrubbing” [*shënim i ekspertëve: term që ne e interpretojmë si puçrra për shkak të përshkrimeve të ngjashme të përshkruara në nivelin e pleurës parietale në ekzaminimin internë*],
- Në rrotullimin e trupit, gjatë autopsisë, përmbajtje gjaku rridhnin nga vrima e hundës dhe gojës ngjyrë e kuqe e zbehtë, e interpretuar nga mjekët ligjorë se vinte nga edemi pulmonar.
- Një mungesë anomalie në nivelin e mukozës së brendshme të buzëve,
- Në nivelin e këndit mandibular të djathtë, rreth 4 cm të bregut inferior të syrit, një zonë lëkurore e kuqërremtë –trëndafiltë, e përshkruar si një “eriteme”, ovale, e gjatë 10 x 9mm. Tri zona lëkurore të kuqërremta të ngjashme janë të dukshme në nivelin e faqes laterale të ekstremitetit inferior të parakrahut të djathtë, të gjatë 5 x 5mm deri në 12 x 8 mm, afër njëra tjetrës. Sipas interpretimit të mjekëve ligjorë, këto ngjyrim të kuqërremta të lëkurës do të mund të ishin provokuar gjatë transportimit ose rianimit mjekësor,
- Në nivelin e anës së djathtë të qafës, rreth 4 cm nën mandibulë dhe rreth 4 cm mbi klavikulën e djathtë, është prania e gërvishtjeve të gjata (ang. “scratches”) të lëkurës, gati paralele ndërmjet veti, të orientimit të anuar në krahasim me boshtin e madh të trupit, të kuqe në të trëndafiltë, të një gjatësie rreth 7 dhe 9 cm dhe gjerësi 1 deri në 2 mm dhe thellësi rreth 1 mm. Këto lëndime janë ndarë në tri grupe, secili nënkupton 3 dhe 4 plagë. Skajet e këtyre plagëve janë të lëmuara, të rregullta me gjurmë gjaku. Këto lëndime janë interpretua “me besim” (ang. “it can be confidently stated that [...]”) nga mjekët ligjorë si lëndime që janë provokuar nga një veprim i një objekti që pret me një teh të hollë i cili ka vepruar në mënyrë tangenciale në nivelin e sipërfaqes së lëkurës,
- Në nivelin e faqes laterale të majtë të toraksit, “shenja të defibrillator”,
- Në nivel të kyçit të djathtë (ang. “right hand joint”), shenja të një shpimit venozë duke e lidhur me intervenimin mjekësor,
- Nën bërrylin e majtë tri “signes” [*shënim i ekspertëve: term të cilin ne nuk e kuptojmë*] me ngjyrim vjollce në të përhinte me diametër prej 5 mm që paraqet “sings” [*shënim i ekspertëve: sigurisht gabim shtypi, ne e interpretojmë këtë fjalë si “shenjë”*] të moçme që nuk korrespondojnë me ngjarjet, sipas mjekëve ligjorë,
- Në nivelin e regjionit inferomedial të kyçit të majtë, tri gërvishtje të gjata, paralele ndërmjet veti, të vendosura në pozita gati horizontale të kuqe, me skaje relativisht të

rregullta, të një gjatësie ndërmjet 3 dhe 5 cm, me gjerësi që është rreth 1 dhe 2 cm dhe në thellësi prej 1mm. Këto lëndime janë interpretuar “me besim” (ang. “it can be confidently stated that [...]”) nga mjekët ligjor se janë shkaktuar nga një objekt i ngjashëm me atë që ka provokuar lëndimet e qafës të përshkruar më herët, ose një objekt i ngjashëm.

Ne veçojmë elementet e mëposhtme të ekzaminimit intern të trupit të përfshirë në raportin e autopsisë:

- Në nivelin e rrënjës së gjuhës, rreth 5,6 cm nga maja e gjuhës, dy shqyerje (ang. “rips”) nga të dy palët e gjuhës, paralele në mes veti, janë 15 x 10 mm dhe 4 mm të thella në të djathtë, të gjata 15 x 8 mm dhe 6 mm thellësie majtas. Sipas interpretimit të mjekëve gjyqësor, këto shqyerje janë shkaktuar nga veprimi mekanik i një instrumenti me përbërje të fortë në momentin e mbylljes të pjesës së thellë të zgavra bukale, për shkak të rezistencës së bërë nga qiellza e fortë,
- Në nivelin e pleurës së organeve të brendshme bilaterale, prani e disa pikave hemorragjike (ang. “drops of hemorrhage”) [*shënim i ekspertëve: që ne e interpretojmë si puçrra*] të lokalizuara në veçanti në nivel të sisures (hulli), me një diametër ndërmjet 2 dhe 4 mm. Sipas interpretimit të mjekëve gjyqësor kemi të bëjmë me njolla të Tardieu të interpretuara si shenjë karakteristike të vdekjes me asfiksi.
- Një frakturë të brinjës së 4<sup>te</sup> majtas, rreth 3 cm në të majtë të kafaz i kraharorit, pa reagim vital në periferi, i shkaktuar nga matja e rianimit,
- Pesha e trurit është 1650g.
- Një edeme diskrete të parenkimit cerebral,
- Përgatitja e indeve të buta të qafës dhe mungesa e lëndimit të këtyre të fundit,
- Mungesë e lëndimit në zgavrën e gojës,
- Mungesë e lëndimit të kockës hioide (lingual)
- Në nivelin e trakesë dhe të bronkeve kryesore, prani e një sasi të vogël të një substance të kuqe-e lagësht,
- Mushkëritë janë kongjestive, të ënjtura dhe pjesërisht emfizemë. Në prerje dhe në shtypje të parenkimës, rrjedh një substancë mukoze e trëndafiltë. Mushkëria e djathtë peshon 850 g dhe mushkëria e majtë peshon 830g,
- Lukthi përmban një substancë të lagështë e përbërë nga mbetjet ushqimore ngjyrë kafe e çelë.

### Histopatologjia :

Raporti i autopsisë zbulon diagnoza histopatologjike si më poshtë.

- Një hemorragji alveolare,
- Një kongestion dhe një edeme akute të mushkërive,
- Prani e materialeve ushqyese në dritën e bronkioleve.

### Toksikologjia:

Raporti i autopsisë zbulon se ekzaminimet toksikologjike të shpejta janë realizuar gjatë autopsisë dhe janë zbuluar negative për 13 substanca ( medikamente dhe drogë).

### Shkaku dhe mekanizmi i vdekjes:

Paragrafi për shkaqet dhe mekanizmat e vdekjes raportojnë elementët e mëposhtme:

- Vdekja e z. DEHARI Astrit është rezultat i një asfiksie mekanike përmes obstruksionit të rrugëve respiratorë të epërme me një objekt me përbërje të fortë.
- Mekanizmi i vdekjes mund të shpjegohet si një ndalesë refleksi të punës kardiake (refleks vaso-vagal) mundësisht i ndihmuar me stimulim të pleksusit nervor të laringut ose të spazmave laringale.
- Lëndimet e përshkruara në pikën 1 dhe 2 [*shënim i ekspertëve: pikat 1 dhe 2 referojnë në lëndimet e konstatuara në nivel të kyçit të majtë dhe të qafës; cf. "ekzaminim ekstrën"*] janë sigurisht lëndime të vetë-shkaktuara të llojit "hezitim", të shoqëruar me një hemorragji të jashtme por e cila nuk ka provokuar një shok hemorragjik.
- Ekzaminimet toksikologjike të praktikuara deri më tani në përpilimin e raportit të autopsisë janë zbuluar negative për medikamente dhe drogë.

### **m. Kartoni i "profilit" të mbajtësit DEHARIAstrit, sipas Qendrës së paraburgimit në Prizren, pa datë**

- Data e pranimit në qendër të paraburgimit në Prizren: më 1 shtator 2016 në ora 16:00
- I lindur në Berne
- Profesionit: student [*shënim i ekspertëve : viti i gjashtë i mjekësisë*]
- I martuar
- Nacionaliteti : shqiptar
- Feja : Islam
- Gjatësia : 170 cm
- Peshë 76 kg
- Në burg për herë të parë
- I akuzuar : veprimtari terroriste dhe posedim ilegal të armës

Informatat për takimet me drejtorin e burgut:

- “a keni probleme shëndetësore që ne duhet t’i dimë? Po, migrenë”

Informacionet e “Prison Health Department”

- Kualifikimi : “Fakultet Profesionit : Mjek” [shënim i ekspertëve: viti i gjashtë i mjekësisë]
- Duhaxhi : Po
- Alkool : Jo
- Sëmundje kronike : jo
- Terapi aktuale. Jo
- Dukja e përgjithshme : e mirë

**n. Raporti mbi gjendjen psikologjike të mbajtësit DEHARI Astrit i dr Shpresa Goqaj më 06 shtator 2016**

Dy takime janë zhvillua me z. DEHARI Astrit, i pari më 06 shtator 2016 dhe i dyti më 08 shtator 2016.

Nga këto takime, del se gjendja psikologjike e z. DEHARI Astrit është e mirë dhe stabile. Ai nuk ka histori psikologjike ose psikiatrike as edhe mendime apo tentativa për vetëvrasje në të kaluarën. Gjatë takimeve, ai nuk ka shprehur mendime vetëvrasjeje. Ai tha se nuk konsumon drogë, alkool dhe as duhan. Si moment më të vështirë të jetës së tij, ai përmend humbejn e vëllait të tij. Gjumi dhe apetiti janë të mirë. Ai ka vullnet.

**o. Raporti mbi historinë sociale të z. DEHARI Astrit, sipas Qendrës së paraburgimit në Prizren, pa datë**

I mbajturi tregon se banon me gruan e tij dhe se kanë marrëdhënie të mira me prindërit e tij dhe motrën e tij. Ai tregon se posedon një pasuri të patundshme, se ka kushte të mira të banimit dhe hapësirë të mjaftueshme. Situata ekonomike e familjes është e mirë, edhe pse ai nuk tregon prejardhjen e të ardhurave. Ai është i shoqërueshëm, i arsyeshëm (ang. “rational”) dhe se ka shumë miq që janë nga studimet dhe nga organizata. Autoritetet tregojnë se nuk ka pasur veprime e penale z. DEHARI Astrit as edhe familja e tij. I mbajturi thotë se ndihet tërësisht i pafajshëm, se arma e gjetur tek ai i takon babait të tij dhe vëllait të ndjerë. Nuk është e vërtetë se ka qenë i implikuar në veprimtaritë për të cilat dyshohet. Pas mbajtjes së tij, ai mendon të kthehet tek familja, studimeve dhe punës së tij.

Përshtypjet e asistentit social:

I burgosuri duket i hapur, komunikativ dhe i qetë. Tani për tani nuk ka elemente që tregojnë ankthe emocionale as vështirësi të përshtatjes në rrethin r tij. Ai mohon kategorikisht se ka qenë i implikuar në aktivitetet për të cilat qortohet.

### III. ANALIZA E RE DHE INTERPRETIMET E DISA ELEMENTEVE TË PROCEDURËS NGA CURML

- a. Videot e autopsisë të z. DEHARI Astrit dhe albumet fotografike të autopsisë së z. DEHARI Astrit (të realizuara nga policia e Kosovës)

Ne kemi pranuar 2 DVD dhe 3 CD-ROM që janë :

- 1 DVD që bartë indikacionet 2016-GA-2746 dhe përmban fashikujt e mëposhtëm:
  - o 14 fashikuj video të emëruar M2U00502 në M2U00515
- 1 DVD që bartë indikacionet 2016-GA-2746 dhe përmban fashikujt e mëposhtëm:
  - o 14 fashikuj video të emëruar M2U00513 në M2U00528
- 1 CD-ROM që bartë indikacionet 2016-GA-2746 dhe përmban, në veçanti fashikujt në vazhdim:
  - o 118 fotografi në një dosje të titulluar "Fotot e autopsisë"
- 1 CD-ROM që bartë indikacionet 2016-GA-2746 dhe përmban fashikujt e mëposhtëm:
  - o 16 fashikuj video të emëruar M2U00513 në M2U00528

Regjistrimet video të autopsisë zbulojnë sekuenca të ngjarjeve të mëposhtme :

- Në një sallë të autopsisë njëzet persona rreth një trupi të vendosur në një thes të bardh të mbyllur, mbi një karrocë metalike,
- Thesi që mbante trupin është zhvendosur mbi tavolinën e autopsisë,
- Thesi është hapur, zbulon trupin e një njeriu (z. DEHARI Astrit). Trupi është i veshur dhe paraqet disa fasha.
- Rrobat dhe lidhjet janë hequr,
- Një ekzaminim i jashtëm i trupit është kryer,
- Kampionet e nën-unguale<sup>1</sup> në nivelin e të dy duarve janë kryer,
- Një ekzaminim dhe fotografi të rrobave janë kryer,
- Një kampion në nivelin e uretrës distale është realizuar,
- Në ekzaminim i brendshëm me :
  - o Autopsi e lëkurës dhe të indeve nën-lëkurore me një prerje vertikale shtrihet në pjesët e sipërme të qafës në simfizë pubike,
  - o Autopsi i rrafshit infra-muskulor
  - o Hapja e koshit të kraharorit në kostotomi
  - o Kampioni i gjakut ekstravazë në gjirin mediastinale anterior pas tërheqjes së plastronit,
  - o Heqja e intestineve,
  - o Kampioni i urinës me gjilpërë,
  - o Kampioni i gjakut në nivelin e enëve iliake me gjilpërë,

---

<sup>1</sup> E thonjve

- Vizualizimi i organeve të brendshme në një bllok të vetëm anatomik (metoda e Letulle) mbi tavolinën e autopsisë,
- Hapja posteriore e faringsit , të ezofagut dhe të lukthit,
- Kampioni i materialit intra-gastrik,
- reseksioni i veshkave, shpretkës, gjëndrave adrenale dhe pankreasit, mëlçisë dhe ezofagut,
- hapja posteriore e laringut dhe e trakeve,
- ekspozimi i dritës së laringut duke “larguar” nga prapa aparatit kërcor të laringut,
- reseksioni i mushkrave,
- reseksioni i zemrës,
- hapje e kapakut të kokës
- nxjerrja e encefalonit
- mbyllja e trupit
- larja e trupit.

Duke u nisur nga regjistrimet video dhe nga fotografitë e autopsisë, ne vërejmë disa pila që kërkojnë plotësimet dhe modifikimet e mëtejme në krahasim me konstatimet e bëra nga mjekët-ligjorë që kanë kryer autopsinë:

- Në ekzaminimin e jashtëm të trupit:
  - Në nivelin e regjionit frontal superior, të mesëm dhe paramedian të djathtë, pjesërisht të mbuluar me flokë, i vendosur rreth 4,5 cm mbi vetullën e djathtë, katër pllaka të kuqe pergamene, ovale, afër njëra tjetrës, shtrihen mbi një sipërfaqe rreth 4 cm të boshtit të madh (i përshkruar sikur lëkurë e lënduar (ang. “wounded”) në raport të autopsisë),
  - Në nivelin e konjunktivës bulbar inferior të djathtë, konjunktiva bulbare superiore dhe inferiore të majtë, të konjunktivës palpebral inferior të djathtë dhe konjunktiva palpebrale inferiore e majtë, petechiae (konjunktiva palpebral superiore bilaterale dhe bulbare superiore e djathtë nuk janë në foto); përshkrimi si pika (ang. “drops”) hemorragjike në raportin e autopsisë),
  - Në nivelin e skajit (bregut) anterior-inferior të mandibulës, në të djathtë, e vendosur rreth 2, 5cm nga prapa majës së mjekrës, një eksimozë e kuqe-kafe, ovale, keq e përkufizuar dhe e gjatë rreth 1,7 x 0,8 cm (nuk është përshkruar në raportin e autopsisë).
  - Në nivelin e regjionit pre-artikular të majtë një dermabrasion i kuqërremtë, linear, horizontal, i gjatë 1 x më pak se 0,1 cm, në afërsi të tre zonave lëkurore të skuqura, me madhësi dhe forma të ndryshme, më e madhja 0,5 cm e boshtit të madh dhe më e vogla nga 0,2 cm të boshtit të madh (të pa përshkruara në raportin e autopsisë),
  - Në nivelin e regjionit latero-cervikal të djathtë, i vendosur 2,5 cm nën bregun inferior të mandibulës dhe rreth 4 cm mbi klavikulën e djathtë, shumë plagë sipërfaqësore me skaje të pastra, lineare, të pjerrtë poshtë dhe para trupit, të skuqura, gati paralele në mes veti, me gjatësi që mbërrijnë deri në 7 cm (të



përshkruara si gërvishitje (ang. "Scratches") në raportin e autopsisë). Nga këto plagë sipërfaqësore, vërehen gjurmë gjaku të tharë në formë të rrjedhës horizontale,

- Në nivel të regjionit latero-cervikal të djathtë, të vendosura në pjesën superiore plagët e përshkruara më parë, janë shumë pllaka të holla lineare, pjerrtas të drejtuara poshtë dhe përpara trupit, të skuqura, globalisht paralele në mes veti, të një gjatësie që prekin 7cm (të përshkruara si gërvishitje (ang. "scratches") në raportin e autopsisë),
- Në nivelin e regjionit latero-cervikal të djathtë, i vendosur në nivelin e pjesës më të prapme plagë dhe gërryerje të dermës (dermabrasion) të përshkruara më herët, pllaka të holla të skuqura me trup dhe forma të ndryshme, të predispozuara ndemjet veti globalisht në formë të harku të konveksitetit anterior, që janë 3 deri në 7 mm të diametrit (të pashkruara si lëkurë e lënduar (ang. "wounded") në raportin e autopsisë),
- Në nivelin e regjionit pre-sternal, pektoral i majtë dhe latero-torakali i majtë mavijosje të purpurta dhe pllaka lëkura të skuqura me madhësi dhe formë të ndryshme, disa "në formë" (të përshkruara si "shenjat e defibrilatorit" në raportin e autopsisë),
- Në nivelin e palosjes së bërrylit të djathtë është një aspekt i skuqur dhe i rrumbullak i cipës, i rrethuar me një fryrje të kaltës me aspekte të një pike të injeksionit (e përshkruar si shenjë e një injektimi venoz i lidhur me intervenimin mjekësor në nivelin e "right hand joint"),
- Në nivelin e faqes mediale (në pozitë anatomike) dhe distale të parakrahut të djathtë, tri mavijosje ngjyrë të kuqërremtë, të rrumbullakëta dhe pak ovale, keq të kufizuara, më e madhja ishte 2,5 x 1,4 cm dhe më e vogla 0,6 cm të diametrit, prej të cilave dy janë të vendosura në boshtin e njëjtë longitudinal, rreth 0,9 cm njëra nga tjetra dhe e trata është e vendosur proksimale dhe laterale ndaj dy tjerave dhe është 2,5 cm nga më e afërta (të përshkruara si eritema në raportin e autopsisë),
- Në nivelin e faqes dorsale të gishtit të tretë të dorës së djathtë, ngjitur me artikulacionin metakarpo-falanger, një pikë në të kuqe-kafe, ovale, keq e kufizuar e gjatë 1,5 x 1 cm (e përshkruara si eritema në raportin e autopsisë),
- Në nivelin e faqes posteriore të bërrylit të majtë tri njolla të purpurta, mirë të kufizuara, që maten deri në 0,5 cm të diametrit të një natyre të papërcaktuar (të përshkruara si "signes" në raportin e autopsisë),
- Në nivelin e faqes anteriore të kyçit të majtë, plagë të shumta sipërfaqësore me skaje të pastra, lineare, horizontale, të skuqura, gati paralele në mes veti, të një gjatësie që arrijnë deri në 3 dhe 5 cm (ang. "scratches" në raportin e autopsisë),
- Në nivelin e faqes anteriore distale të parakrahut të majtë, rreth 5 cm nën plagët sipërfaqësore të përshkruara më herët, një pllakë e hollë e kuqërremtë, e zgjatur, me gjatësi prej 1 x 0,6 cm, në kontakt me pjesën mediale dhe një cikatrixë hipopigmentale, lineare, e pjerrtë e drejtuar në anën e poshtme dhe pak

djathtas të trupit e gjatë 2,3 x 0,6 cm ( të përshkruara si lëkurë e dëmtuar (ang. "wounded") në raportin e autopsisë),

- Në ekzaminimin e brendshëm të trupit :
  - o Në nivelin e secilit skaje lateral të bazës së gjuhës, një shqyerje lineare, me skaje të pastra, jo hemorragjike, simetrike dhe e gjatë 15 x 10 mm dhe 4 mm e thellë në të djathtë dhe 15 x 8 mm dhe 6 mm e thellë në të majtë (sipas matjeve të realizuara gjatë autopsisë; të përshkruara sikur shqyerje "rips" në raportin e autopsisë),
  - o Në nivelin e skajit lateral të djathtë të gjuhës, i vendosur rreth 1,7cm përpara në dilaceration<sup>2</sup> i përshkruar më parë, një dilaceration sipërfaqësor, arciforme<sup>3</sup> me konkavitë superior, i gjatë 1 x 0,2cm (i pa përshkruar në raportin e autopsisë),
  - o Në nivelin e pjesës së pasme të rafe<sup>4</sup> së mesme të qiellzës së butë, i vendosur mu përpara në uvule qiellzore një dekolation<sup>5</sup> i kuq-vjollce e mukozës, i zgjatur që evokon një zonë të infiltrimit hemorragjike.
  - o Në nivelin e pjesës posteriore paramediale të djathtë të qiellzës së butë, i vendosur rreth 0,4 cm nga dekolation kuq-vjollce të përshkruar më parë, një zonë e dytë dekolation kuq-vjollce e mukozës rreth 0,5 x 0,2 cm, që evokon një zonë të infiltrimit hemorragjik, e vendosur në kontakt me një zonë të dilacertion<sup>6</sup> që mund të korrespondonte me faqe të prerjes të bllokut orofaringal gjatë autopsisë.
  - o Petechiae nën pleurë.

#### b. Prerja histologjike e autopsisë së z. DEHARI Astrit

Ne kemi pranuar 15 prerje histologjike me ngjyra të hemitoksilinës dhe të eozinës (HE), domethënë :

- 3 prerje që kanë të bëjnë me parenkimën kardiake me indikacionet e mëposhtme :
  - o MA16-286/1 Zemra – H/E
  - o MA16-286/2 Zemra – H/E
  - o MA16-286/2 Koronare – H/E
- 5 prerje që kanë të bëjnë me parenkimën pulmonare me indikacionet e mëposhtme :
  - o MA16-286/3 Mushkëri – H/E
  - o MA16-286/4 Mushkëri – H/E
  - o MA16-286/4 Mushkëri – H/E
  - o MA16-286/4 Mushkëri – H/E
  - o MA16-286/4 Mushkëri – H/E

<sup>2</sup> shkatërrimi i një indi të gjallë me shumë shqyerje të parregullta.

<sup>3</sup> në formë të një harku

<sup>4</sup> Në anatomi paraqet një vijë të formuar përmes kryqëzimit të fibrave që dalin nga dy struktura simetrike.

<sup>5</sup> Pigmentet natyrale të fibrës pastaj ngjyrosen, flokët së pari bëhen të kuqe, të verdhë dhe më pas bionde

<sup>6</sup> Veprim për të shqyer dhunshëm, për të ndarë në pjesë një ind organik

- 1 prerje që kanë të bëjnë me parenkimën renale me indikacionet e mëposhtme :
  - o MA16-286/5 Veshkë – H/E
- 1 prerje që kanë të bëjnë me parenkimën hepatike me indikacionet e mëposhtme :
  - o MA16-286/6 Mëlçia – H/E
- 3 prerje që kanë të bëjnë me parenkimën encefalike me indikacionet e mëposhtme :
  - o MA16-286/7 Truri – H/E (tru i vogël)
  - o MA16-286/7 Truri – H/E (korteksi cerebral)
  - o MA16-286/7 Truri – H/E (bërthama e gri qendrore dhe ura)
- 1 prerje që kanë të bëjnë me parenkimën surenale me indikacionet e mëposhtme :
  - o MA16-286/8 Adrenale – H/E
- 1 prerje që kanë të bëjnë me parenkimën splenike dhe pankreatike me indikacionet e mëposhtme :
  - o MA16-286/8 Sh/Pan – H/E

Në vazhdim të ekzaminimit e prerjeve histologjike, ne kemi bërë konstatimet në vazhdim:

#### Parenkima encefalike

Të gjitha kampionet e bëra në nivelin e trurit, trurit të vogël dhe trungut cerebral nuk tregojnë asnjë lëndim ishemi, hemorragjik, inflamator, malformatik ose tumoral. Popullata neuronale e urës është e pranishme normale dhe pa shenjë iskemie. Në nivelin cerebral, neuronet e bërthamës së dhëmbëzuar dhe qelizat e Purkinje janë normalisht të paraqitura dhe pa shenja iskemike.

#### Parenkima kardiake

Epikardi është mirë. Fibrat muskolor të miokardit janë të radhitur në rregull dhe me një diametër të mesëm. Miocitet kardiake kanë skaje citoplazmatike mirë të dukshme dhe hullizime të ruajtura. Nuk ka pigmentim të veçantë në citoplazmë. Bërthamat janë të madhësisë së zakonshme dhe janë pa atipike. Nuk ka infiltrat inflamator të miokardit as edhe të epikardit. Enët e epikardit paraqesin nganjëherë disa trashje të intimes. Disa arteriole të vendosura në gjirin e miokardit paraqesin një mur të trashë. Nuk ekziston çerdhja e fibrozës ose e lipomatozës. Endokardi është mirë.

#### Parenkima pulmonare

Pleura është mirë. Alveolat janë me vëllim të zakonshëm përveç në disa zona subpleurale ku ato janë me vëllim të rritur, por ku nuk shihet këputje e murit alveolar. Në të gjitha kampionet, alveolet janë të mbushura me globule të kuqe dhe me material eozinofilik amorf. Për ndryshe, vërehet në mënyrë shpërndarëse në gjirin e bronkeve, bronkiolve dhe alveoleve, material ushqyes vegjetal në formë të strukturave eozinofile dhe amorfe, nganjëherë në formë të shtrirë, e nganjëherë në formë të rumbullak dhe ovale që paraqesin si kasollëza të zbehta, si dhe fragmente të muskulit skeletik. Nuk ka infiltrime inflamatore të rëndësishme dhe në veçanti nuk vërehet qeliza gjigande shumë bërthamore e llojit të një trupi të huaj. Septat inter-alveolare identifikohen mirë dhe përbëjnë kapilarë të mbushur me globule të kuqe (kongjестive). Bronket dhe bronkiolet paraqesin një mur me strukturë normale dhe përmbajnë shpesh material ushqimor

vegjetal dhe shtazor. Hapësirat peribranshial janë me strukturë të zakonshme. Strukturat vaskulare janë pa lëndime.

#### Parenkima hepatike

Kapsula është mirë. Arkitektura e parenkimës është e rregullt, me lobule hepatike mirë të formuara dhe me hapësira hepatocitare me madhësi normale. Venat centrilobular dhe sinuzoidet janë pa ndonjë veçori. Hapësirat janë me madhësi normale me struktura vaskulare dhe biliare të zakonshme dhe pa lëndime. Në lobulën hepatike, hepatocitet janë anormale.

#### Parenkima renale

Glomerulat janë në numër të zakonshëm dhe celulariteti nuk është rritur. Membranat themelore nuk janë trashur. Matrica ekstra qelizore pa përmbajtje anormale. Tubthaj janë të kalibrit normal, të veshura me qeliza të renditura rregullisht dhe pa ndryshime. Drita e tubthave është e zbrastë. Interstici nuk është e zgjeruar. Nuk ka infiltrim infalamator tubular e as intersticial. Strukturat vaskulare janë të pa lënduara. Vërehet një mbushje vaskulare (kongjестive) në nivelin e papillae (sythave) renale.

#### Parenkima subrenale

Parenkima subrenale është me një arkitekturë normale me një dukshmëri të korteksit dhe të medullas. Petëzim kortikal shihet mirë dhe pa lëndime. Medulla është pa lëndime.

#### Parenkima splenike

Parenkima splenike ka një arkitekturë të ruajtur me pamje të mirë të substancës së bardhë dhe të substancës së kuqe s'ka lëndime të këtyre të fundit.

#### Parenkima e pankreasit

Parenkima është e lobular me një përbërës endokrin ( ishujt e Langerhans) dhe ekzokrin (acini) mirë i zhvilluar dhe pa lëndime. Kanalet sekretues nuk janë të zgjeruar. Nuk ka inflamacion.

Mbi bazën e ekzaminimit të prerjeve histologjike, ne mund të ruajmë diagnozën histopatologjike në vazhdim:

- Edeme pulmonare hemorragjike e përhapur.
- Kongjestiononi pumonar i përhapur.
- Bronkoaspirimi i përhapur me material ushqyes.

#### **c. Albumi fotografik i vendit të zbulimit të trupit**

Ne kemi pranuar një album fotografik në skedarin Microsoft<sup>R</sup> Word të titulluar "5.Fotoalbum 2016-GA-2746 TK-90-2016 (NXPPowerLite Copy)" që përmban 183 forografi me ngjyra dhe legjendë të vendit të zbulimit të trupit. Duhet të theksohet se fotot në formatin digjital nuk na janë dërgua.

Në vazhdim të ekzaminimit të këtij albumi fotografish, ne kemi bërë këto konstatime:

- Asnjë fotografi e trupit të z. DEHARI Astrit në qeli nuk është në dispozicion ( për të rikujtuar, trupi i z. DEHARI është transferuar në lokale të ndryshme pas zbulimit të tij, për një kujdes mjekësor),
- Numër i madh objektesh të shpërndara mbi tokë të qelisë,
- Gjurmët e një materiali të kuqërremtë që evokon gjak që njollos tokën e qelisë,
- Gjurmë të materialit të përhinte janë të dukshme mbi tokë,
- Mbi tokë pjesët kryesore, vërehen në veçanti objektet e mëposhtme:
  - o Një shishe plastike që paraqet një ari të vogël, me skaje të lëmuara, një pjesë e mbuluar me material ngjyrë kafe, me madhësi 17 cm e gjatë me një bazë me madhësi rreth 5cm të diametrit në pjesën më të skajshme dhe përfaqësisht 6cm rreth 1.5 cm të këtij ekstremiteti të skajshëm,
  - o Një sapun drejtkëndësh ngjyrë roze, i mbuluar pjesërisht me material ngjyrë kafe me madhësi rreth 5 x 7,7cm,
  - o Një sfungjer i mbështjellë me një këmishë të zezë,
  - o Një lidhëse e klatër e këpucave me madhësi prej 57cm,
  - o Një çajnik me kabull elektrike (asnjë fotografi në dispozicion nuk mundëson të vlerësohet gjatësia e kabllit),
  - o Një grumbull peshqirësh, disa të përmbajnë gjurmë ngjyrë kafeje,
  - o Një grumbull shtupa pambuku, disa me gjurmë ngjyrë kafeje,
- Brisqe rroje shihen në një kosh mbeturinash të dhomës kryesore (me gjurmë të kuqërremta që paraqesin gjak) dhe në një kosh të bardhë i vendosur në tokë (pa gjurmë në sipërfaqe). Shumë brisqe rroje shihen në veçanti në sirtarët e qelisë ( s'ka fotografi në një rrafsh të afruar në dispozicion),
- Lidhur në një krevat, shihet një "sigjim" të përhinë, me gjatësi prej 85 x 05 cm,
- Në xhepin e një xhakete të varur në krevat, shihet një "sigjim" gri madhësia e të cilit nuk mund vlerësohet me rezolucione të fotografive në dispozicion,
- Në tualet:
  - o Mbi tokë, gjendet një stilolaps që përmban gjurmë të kuqe që evokojnë gjak, i lidhur me një lidhëse blu-zeze që evokon një lidhëse këpucësh me madhësi përfaqësisht 25 cm e gjatë ( vështirë për ta matur mbi fotografitë në dispozicion),
  - o Mbi tokëm në një legen, gjenden copa të zhytura në një lëng me disa fluska në sipërfaqe, që evokojnë rroba të ulura në ujë me sapun.
  - o Mbi lavamanin metalik shihen gjurmë të skuqura që evokojnë gjak
  - o Në lavamanin metalik, një brisk rroje me gjurmë të skuqura që evokojnë gjak

#### IV. PËRMBLEDHJE DHE DISKUTIME

##### a. Hetimet policore

Në bazë të të gjitha hetimeve të kryera nga autoritetet lokale mbi vendin e gjetjes së trupit, ne u hedhim një vështrim elementeve të më poshtme:

- Mbi dyshemenë e qelisë A3 gjendeshin këto elemente:
  - o gjurmë gjaku
  - o gjurmë të materialeve të kuqërremtë mbi dysheme,
  - o një sfungjer e mbështjellë në një këmishë të zezë e ndotur me një material që evokonte jargë dhe vjellje,
  - o një lidhëse e kaltër me madhësi rreth 58 cm,
  - o peshqirë me material të kuqërremtë që evokonte gjak,
  - o një shishe plastike me kapak të verdhë:
    - që përmbante lëngë që evokonte mjaltë
    - pjesërisht e mbuluar me material ngjyrë kafeje që evokonte gjurmë gjaku,
    - me skaje të lëmuara
    - me madhësi rreth 17 cm e gjatë me një bazë me diametër rreth 5 cm të pjesës së saj më të skajshme dhe rreth 6 cm me rreth 1,5 cm të këtij ekstremiteti të skajshëm,
  - o një çajnik me një kabull elektrike të gjatë 90 cm,
  - o një sapun kënddrejtë, pjesërisht i mbuluar me materia ngjyrë kafeje që evokonte gjak, me madhësi rreth 5 x 7,7 cm,
  - o një brisk rroje me 5 tehe i mbuluar me pika të kuqe që evokonin gjak.
- Varur për krevati gjendeshin objekte prej najloni që formonin një lloj litari, më i gjati 1 x 85 cm dhe më i shkurti 1 x 36 cm.
- Në tualet gjendeshin këto elemente:
  - o gjurmë gjaku mbi dysheme,
  - o një stilolaps që përmbante gjurmë të kuqe që evokonin gjak, i lidhur sigurisht me një lidhëse këpucësh,
  - o një lavaman prej metali mbi të cilin gjurmë gjaku ishin të dukshme,
  - o në lavaman, një pjesë metalike që dyshohet se ishte brisk rroje me gjurmë të kuqërremta evokim i gjakut.

Në bazë të hetimeve tjera policore, ne u hodhëm një vështrim këtyre elementeve

- Bashkë mbajtësit e z. DEHARI, z. MAKOLLI Naser, z. LASKU Frrok dhe z. GASHI Adonis, nuk paraqitnin lëndime, sipas konstatimeve të policisë të bëra më 17 nëntor 2016, që do të thotë 12 ditë pas vdekjes së z. DEHARI Astrit. Duhet të vihet re menjëherë ky afat është shumë i gjatë dhe se gjurmët eventuale ose lëndimet kanë mundur ndërkohë të zhduken.
- Gjurmët digjitale të pa shfrytëzueshme ishin të pranishme në kutinë prej plastike, një çajnik dhe një orë.
- Asnjë përzierje e gjurmëve digjitale nuk është identifikuar mbi bartësit e ndryshëm të analizuar në qeli ose mbi rrobat e z. DEHARI. Këto rezultate janë papritura në një dhomë që banonin 4 individë. Për këtë arsye, ne jemi në dispozicion për analiza gjenetike të mëvonshme.
- Nuk kishte evidencë manipulimesh të regjistrimeve vise të qendrës së paraburgimit në Prizren (ekzaminim i pavarur austriak).

- Regjistrimet video kanë zbuluar elementët e më poshtme:
  - o Z. DEHARI e ka marrë shujtën e vetë (12:58)
  - o Z. DEHARI ka shkuar në dush (13:50)
  - o Z. DEHARI kthehet në qeli pas dushit (14:09); duke u nisur nga ky moment, ai nuk del më nga qelie.
  - o Një i mbajtur del nga qelia A3 në korridor, shikon dhe kthehet prapë në qeli (14:11),
  - o Gardiani e inspekton qelinë A3 dhe e mbyll derën (14:11).
  - o Dy të mbajtur dalin nga qelia A3 (14:52)
  - o Një i mbajtur del nga qelia me një kasketë dhe me veshje sportive (14:52).
  - o “Të gjithë të mbajturit lëshojnë korridorin për në shëtitje”(14:53).
  - o Gardiani afrohet tel qelia A3, ngrit dorën sikr të bënte një përshëndetje dhe e mbyll derën (14:53).
- Proceset verbale të zbulojnë këto elemente:
  - o Z. DEHARI është përshkruar nga bashkë mbajtësit dhe nga gardianët si një njeri i qetë, pa probleme, që kishte marrëdhënie të mira me bashkë mbajtësit dhe gardianët. Ai nuk vuante nga asnjë presion nga askush, përfshirë këtu edhe gardianët.
  - o Bashe mbajtësit e tij nuk mendonin se do të kishte mundësi t’i bënte keq vetes.
  - o Z. DEHARI e kishte shkruar në bllokun e tij adresën e një nga bashkë mbajtësit (z. MAKOLLI), një seri numrash telefonikë të anëtarëve të familjes dhe miqve. Arsyeja për këtë ishte se z. DEHARI dëshironte që Z. MAKOLLI të paralajmërojë rrethin e tij në rast se transferohej në burg për hetime nga ana e policisë ose e Ministrisë publike. Avokati i tij do të duhej gjithashtu të paralajmërohej.
  - o Më 5 nëntor 2016 z. DEHARI nuk ishte i mërziur dhe nuk kishte sjellje të pazakonshme.
  - o Më 5 nëntor 2016, gjatë dushit z. DEHARI është rruar me një brisk rroje dhe pastaj ia ka kthyer gardianit.
  - o Më 5 nëntor 2016 z. DEHARI ka qëndruar në qeli, duke thënë (sipas dëshmitarëve) se nuk ndjehej mirë, kishte dhimbje koke, dhe parashikonte të bënte një thirrje telefonike dhe ta pastronte qelinë.
  - o Z. MAZREKU ishte i mbajtur në qelin A2 dhe gjendje në qelinë e tij gjatë shëtitjes së mbajtësve pasi që nuk ndjehej mirë. Gjatë kësaj kohe, ai ishte vetëm në qeli, gjysmë i fjetur. Por rreth fundit të shëtitjes, përafërsisht 10 minuta para se të vinin të tjerët, ai ka dëgjuar dy ose tri zhurma të lehta, pa pasur mundësi që të jepte më shumë saktësi sa i përket natyrës së zhurmave as edhe të tregonte prej nga vinin.
  - o Gjatë zbulimit të z. DEHARI nga bashkë mbajtësit, ai ishte në shpinë, në tokë, me një shishe mjalti prej plastike të vendosur në gojën e tij nga pjesa e prapme. Shishja ishte, sipas një dëshmitari, e futur më shumë se gjysma. Ai

paraqet në veçanti lëndime në nivelin e pjesës së djathtë të qafës së tij dhe të kyçit të majtë. Ai ishte i lagur në nivelin e organeve gjenitale të jashtme.

- Gardiani, z. KASTRATI, i ka dhënë ndihmën e parë duke e larguar shishen prej plastike rreth 5 cm në gojën e tij. Pasi që e hoqi shishe, ai konstatoi se z. DEHARI lëvizte gojën e tij dhe se ajri dilte nga goja e tij.
- Infermierja intervenon aty për aty dhe ka konstatuar se të vjella gjendeshin pranë z. DEHARI. Ajo ka konstatuar se ai kishte një puls në nivelin e qafës dhe se ai merrte frymë.
- Ekipi mjekësor që intervenon pastaj në qendrën e paraburgimit nuk ka konstatuar shenja jete.

#### **b. Dosja mjeko-psiko-sociale e z. DEHARI Astrit**

Në rrafshin somatik, ne mund të ruajmë elementet e mëtejme që kanë të bëjnë me z. DEHARI Astrit:

- asnjë sëmundje kronike
- nuk konsumon alkool,
- ka migrenë,
- nuk ka trajtim.

Në rrafshin psikologjik ne mund të ruajmë elementet e mëtejme që kanë të bëjnë me z. DEHARI Astrit:

- gjendja psikologjike e mirë dhe stabile,
- nuk ka prejardhje psikologjike ose psikiatrike,
- s'ka mendime ose tentativa për vetëvrasje në të kaluarën,
- s'ka mendime vetëvrasëse gjatë takimeve me psikologët në qendrën e paraburgimit në Prizren (6 dhe 8 shtator 2019),
- gjumin dhe apetitin e ruajtur,
- vullnet të mirë.

Në rrafshin e analizave psikiatrike të shkrimeve të tij ne mund të ruajmë elementet e mëtejme që kanë të bëjnë me z. DEHARI Astrit:

- s'ka nocion krize emocionale të rëndë as edhe shkëputje të mëdha emocionale,
- prani e një gjendjeje emocionale që ngarkohet kohë pas kohe sa u përket perceptimeve, të ditës, të situatës politike, nganjëherë, ai shprehte mërzi, pasiguri dhe një pesimizëm,
- disa nga shkrimet reflektojnë një gjendje emocionale të ndjeshme dhe skeptike, është e mundshme që korrespondojnë me një gjendje emocionalisht të brishtë.

Në rrafshin social ne mund të ruajmë elementet e mëtejme që kanë të bëjnë me z. DEHARI Astrit:

- banon me familjen e tij,
- marrëdhënie të mira familjare (prindërit dhe motra),



- kushte të mira banimi,
- situatë të mirë ekonomike,
- thuhet i shoqërueshëm, i arsyeshëm (ang. "rational") dhe kishte shumë miq
- Z. DEHARI dukej i hapur, komunikativ dhe i qetë. Ai nuk paraqiste emocione shqetësuese as edhe vështirësi të përshtatjes në rrethin e tij.

### c. Autopsia e z. DEHARI Astrit dhe interpretimet mjeko-ligjore

#### Diagnoza anatomo-patologjike (sipas vlerësimit tonë):

- në nivelin e regjionit frontal superior, katër pllaka të pergamene, mediane dhe paramediane e djathtë, pjesërisht të mbuluara me flokë,
- në nivelin e konjuktive bulbaire<sup>7</sup> bilaterale dhe të konjuktiva palpebrale inferiore bilaterale dhe petechiae<sup>8</sup>,
- në nivelin e këndit mandibular të djathtë, një ecchymosis<sup>9</sup> e kuqe-murrme dhe ovale,
- në nivelin e bregut anterior-inferior të djathtë të mandibulës, një ecchymosis e kuqe-murrme dhe ovale,
- në nivelin e regjionit pre-artikular të majtë një dermabrasion<sup>10</sup> i kuqërremtë, me madhësi dhe formë të ndryshme latero-cervikal i djathtë:
  - o shumë plagë sipërfaqësore me skaje të pastra, të grupuara, lineare, të pjerrëta poshtë dhe para trupit, të skuqura dhe gati paralele në mes veti,
  - o shumë plaka të pergamene, të pjerrëta të drejtuara poshtë përpara trupit, të skuqura, globalisht paralele në mes veti, të vendosura në pjesën superiore të plagëve të përshkruar më lartë,
  - o plaka të pergamene të skuqura, madhësi dhe forma të ndryshme, disa në formë harku, rregulluara mes tyre, veçanërisht në formë harku të rrethit me konkavitet anterior, të vendosura në nivelin e pjesës shumë anteriore plagë dhe dermabrasione të përshkruara më lartë.
- në nivelin e regjionit pre-sternal, pektorli i majtë dhe latero-torakal i majtë, ecchymosis vjollce dhe pllaka të pergamene të skuqura, me madhësi dhe forma të ndryshme, disa "në formë",
- në nivelin e palosjes së bërrylit një aspekt i kuqërremtë dhe i rrumbullak i cipave, i rrethuar me një ecchymosis të kaltër,
- në nivelin e faqes mediale dhe distale dhe para krahut të djathtë, tri ecchymosis të kuqe-kafe, të rrumbullakëta dhe ovale, dy prej të cilave janë të vendosura në të njëjtin aks longitudinal, rreth 0,9 cm njëra nga tjetra,

<sup>7</sup> Mukoza transparente që mbulon anën e brendshme të qepallave (konjuktiva tarsale) dhe veshë një pjesë të globit okular.

<sup>8</sup> Pikë e vogël që shfaqet në lëkurë pas hemorragjisë së lëkurës

<sup>9</sup> Eksuzion i gjakut në indin nën lëkuror pas një goditjeje, gjurmë të katërta rezultojnë pastaj.

<sup>10</sup> Dermabrasion është një lloj sipërfaqeje kirurgjikale e lëkurës, e cila zakonisht kryhet në një ambient mjekësor profesional nga një dermatolog ose kirurg plastik i trajnuar posaçërisht në këtë procedurë.

- në nivelin e faqes dorsale të gishtit të tretë të dorës së djathtë, mund të shihet nga artikulacioni metakarpo-falangal, një ecchymosis e kuqe-kafe dhe ovale,
- në nivelin e faqes posteriore të bërrylit të majtë, shumë plagë sipërfaqësore me skaje të pastra, të grupuara, lineare, horizontale, të kuqërremta, gati paralele njëra me tjetrën,
- në nivelin e faqes anteriore të tiers distal, të parakrahut të majtë, rreth 5 cm mbi plagët sipërfaqësore të përshkruara më lartë, një pllakë pergamene e kuqërremtë gjatore në kontakt me një cikatricë e hipopegmentuar,
- në nivelin e secilit breg lateral të bazës së gjuhës, dilaceration linear, me skaje të pastra, jo hemorragjik dhe simetrik,
- në nivelin e bregut lateral të djathtë të gjuhës, i vendosur rreth 1,7 cm nga dilacerationi i përshkruar më herët, një dilaceration sipërfaqësor, në formë harku me konveksitet superior,
- në nivelin e pjesës posteriore të raphe<sup>11</sup> i mesëm i qiellzës së butë, një ngjyrim kuq-vjollce e mukozës që evokon një zonë të infiltrimit, hemorragjik,
- në nivelin e pjesës posteriore paramediale të djathtë të qiellzës së butë, një zonë e ngjyrosur kuq-vjollce të mukozës evokon një zonë të infiltrimit hemorragjik,
- petechiae nën pleurë,
- një edeme pulmonare hemorragjike akute dhe e shpërndarë,
- një kongjestion pulmonar i shpërndarë,
- një bronko-aspirim akut dhe i shpërndarë i materialit ushqimor,
- një frakturë e brinjë se 4 të majtë, pa reagim vital periferik
- edemë diskrete e trurit (pesha e trurit 1650 g.).

#### Komentimet mbi autopsinë dhe diagnozën anatomo- patologjike:

Regjistrimet video të autopsisë nuk përmbajnë sekuencat që tregojnë nxjerrjen e organeve të brendshme në një bllok të vetëm anatomik (metodë e Letulle), këto që janë të dukshme mbi tavolinë të autopsisë. Gjithashtu nuk përmban sekuencën që tregon autopsinë e gjuhës, autopsinë e qafës rrafsh për rrafsh dhe autopsinë e organeve të brendshme torako-abdominale.

Disa nga diagnozat anatomo-patologjike tonat dallojnë nga ato të paraqitura në raportin e autopsisë. Kemi të bëjmë me diagnozat në vazhdim:

- zonat lëkurore të kuqërreme, të rrumbullakëta dhe ovale, të përshkruara në nivelin e këndit të mandibulës së djathtë, të parakrahut të djathtë dhe të dorës së djathtë, janë përshkruar nga mjekët ligjor si eritema. Një eritemë është një lëndim sipërfaqësor, e kuqërremtë, të çastit që zhduken me presionin e lëkurës. Kjo është pasojë e një zgjerimi transitor i enëve të lëkurës. Në bazë të fotografive dhe të videove në dispozicion, ngjyrimi i këtyre lëndimeve është i kuq-kafe. Këto lëndime pra duhet të konsiderohen si ecchymosis.

<sup>11</sup> në anatomi, një vijë mediane që ngjitet në një tendin ose ligament

- Disa zona lëkurore janë përshkruar vetën si të lënduara(ang. “wounded”), pa klasifikime tjera. Kemi të bëjmë me lëndime të regjionit frontal superior të djathtë, latero-cervikale të djathta dhe të pjesëve infero-interne të parakrahut të majtë. Ne i interpretojmë këto lëndime si pllaka pergamene.
- Gërvishtjet (ang. “scratches”) me skaje të pastra dhe të rregullta, të përshkruara në nivelin e regjionit latero-cervikal të djathtë dhe të kyçit të majtë, korrespondojnë me plagë sipërfaqësore dhe janë pasojë e traumave të shkaktuara me një objekt i mprehtë.

Disa lëndime që shihen në ekzaminim ekstern nuk janë përshkruar në raportin e autopsisë, kemi të bëjmë me këto lëndime :

- dermabrasion i regjionit pre-artikular i majtë i kuqërremtë, linear dhe horizontal, i vendosur në afërsi të tri zonave lëkurore të skuqura, me madhësi dhe formë të ndryshueshme, të një natyre të papërcaktuar,
- dilaceration sipërfaqësor i bregut lateral të djathtë të gjuhës, i vendosur përpar dilaceracionit të përshkruar në raportin e autopsisë,
- ngjyrimë të kuq-vjollce të mukozës të raphe të mesme të qiellzës së butë dhe të pjesës posteriore paramediane të djathtë të qiellzës së butë, ndjellëse e zonës së infiltrimeve hemorragjike.

#### Interpretimi i lëndimeve të konstatuara mbi z. DEHARI Astrit:

Ecchymosis janë pasoja të traumave të hapura (përplasje e trupit kundër një apo shumë objekteve shtypëse , presione lokale të forta). Ato janë shumë pak specifike ashtu që të mund të shprehemi për origjinën e tyre të saktë. Tri ecchymosis të vendosura në faqen mediale të kockave të vogla dhe distale të parakrahut të djathtë për nga lokalizimi dhe forma e tyre, mund evokojnë lëndime të shkaktuara nga një shtrëngim dore. Ato mund të shkaktohen dhe gjatë transportit të trupit ose të rianimit mjekësor, ashtu siç janë propozuar nga mjekët ligjorë. Megjithatë një shtrëngim me dorë të llojit të mbajtjes nuk mund të përjashtohet dhe duhet të evokohet. Ecchymosis të vendosura në nivelin e këndit mandibular të djathtë dhe të nivelit të bregut antero-inferior të të djathtë të madibulës mund të jenë shkaktuar nga veprimet e reanimimit ( të llojit “headtilt/chin lift” ose “jaw thrust” në veçanti), por pak mund të flitet për lëndimet që lidhen me transportin e trupit. Ndër të tjera, këto Ecchymosis janë gjetur në lokalizime tipike të gjetura gjatë kapjes në qafë të llojit “çelësi i krahut” ose në forma tjera të dhunës kundër qafës, nga ky fakt, një mekanizëm i tillë i lëndimit nuk mund të përjashtohet dhe duhet të merret parasysh.

Pllakat pergamene janë pasojë e tharjes past-mortum të lëkurës, në shikim të zonave të pastrimit të epidermës pas traumave të hapura (përplasje e trupit kundër një apo shumë objekteve shtypëse, presione lokale të forta) me një përbërës tangjencial. Ato janë shumë pak specifike ashtu që të mundemi të shprehemi për origjinën e tyre të saktë. Ato të vendosur në nivelin e regjionit latero-cervikal të djathtë, frontale superiore dhe në faqen anteriore të parakrahut të majtë munden, sipas mendimit të mjekëve ligjor, të jenë shkaktuar gjatë transportit të trupit, gjatë proceseve të rianimit mjekësor ose nga “konvulsioni” që shoqëron obstrukcionet e rrugëve

ajrore gjatë kontaktit me një objekt të "skenës së kimit". Sipas observimeve tona numri i madh i pllakave të pergamenës të regjionit lateralo-cervikal, globalisht mund të ndahen në dy grupe. Grupi i parë përbëhet nga pllakat pergamene lineare, të pjerrëta për të poshtë dhe para trupit, globalisht paralele në mes veti, të vendosura në të njëjtin aks me plagët sipërfaqësore të të njëjtit lokalizim. Megjithatë ato janë shkaktuar nga një traumë e hapur dhe e topitur. Grupi i dytë përbëhet nga pllakat pergamene me madhësi dhe forma të ndryshme, disa në formë harku dhe në përgjithësi formojnë një hark të rrethit me konkavitë anterior. Sipas mendimit tonë nuk ka mekanizma të bindshme që mund të shpjegojnë se këto plaka pergamene janë paraqitur gjatë transportimit të trupit, gjatë rënimit ose gjatë një konvulsioni. Në fakt, nuk kemi të bëjmë me zona të kapjes ose mbajtjes (në rastin e transportit), zona e intervenimit mjekësor në emergjencë (në rastin e reanimacionit) as zona të dala të trupit të cilat do të ishin përplasur kundër pengesave në rastin e transportit dhe të konvulsionit. Edhe pse nuk aq specifike, ky lloj lëndimi mund të gjendet në rastet e dhunshme ndaj qafës (Saukko end Kinght 2016; Madea 2016). Ollakat pergamene të vendosura në regjionin frontal superior, të regjionit pre-artikular të majtë të faqes anteriore të parakrahut të majtë janë shumë pak specifike ashtu që të mund të shprehem sa i përket origjinës së tyre të saktë. Edhe pse teorikisht ato mund të shkaktohen nga transportimi i trupit, nga manovrat e rianimit ose nga konvulsionet, as aspekti as lokalizimi i këtyre lëndimeve nuk e evokon njërin nga këto tri mekanizma.

Petechiae e konjunktivat okulare dhe palpebrale (qepallave) janë pasoja e një rritjeje e presionit vaskular në gjirin venule të fytyrës, të njëpasnjëshme në një obstrukcion të kthimit venoz nga koka drejt zemrës. Ky lloj lëndimi vërehet shpesh në rastet e kompresionit të qafës ose të toraksit (Madea 2016, Saukko and Knight 2016, Dettmeyer dhe al. 2014, Beauthier 2011). Në rastin e specieve ato mund të shkaktohen nga përpjekjet për të vjellur (Betz, Penning and keil, 1994).

Plagët sipërfaqësore të vëna në pah në nivelin e regjionit latero-cervikal të djathtë dhe të kyçit të majtë janë pasojë e traumave të shkaktuara nga një objekt i mprehtë. Ato përputhen me lëndimet e shkaktuara nga një brisk rroje. Aspekti sipërfaqësor i këtyre lëndimeve dhe karakteri globalisht paralel i tyre mund të çojnë në lëndime të vetë shkaktuara, ashtu siç propozohet nga mjekët ligjorë. Në bazë të videove dhe të fotografive në dispozicion, hemorragjia e jashtme konsektive e këtyre plagëve ishte i një sasi të dobët dhe jo i natyrë së provokimit të një goditje hemorragjike.

Ecchymosis dhe pllakat e pergamene "në formë" të toraksit kanë një aspekt të lëndimit duke u lidhur me manovrimet e reanimimit (masazhi kardiak i jashtëm dhe defibrilation).<sup>12</sup>

Aspektet e skuquara dhe të rumbullakëta të palosjes së bërrylit të djathtë është provokuar nga një plagë e injektimit, edhe pse rezolucionet e fotografive nuk mundësojnë për ta konfirmuar. Aureola e ecchymosis në periferi shkon në drejtim të kësaj hipoteze. Në këtë rast, ajo është ndjellëse një pike të injeksionit.

<sup>12</sup> Një metodë për t'i dhënë zemrës një ritëm normal me një goditje elektrike të fortë, por të shkurtër asinkron.

Dilaserationet e rrënjës së gjuhës dhe i skajit të djathtë të gjuhës janë si pasojë e traumave të shkaktuara nga një objekt i mprehtë ose shpuesit dhe tehut. Mungesa e infiltrimit hemorragjik në periferi dëshmon lëndime të shkaktuara në periudhën past-mortum. Nga lokalizimi dhe simetria e plagëve, ato janë shkaktuar, sipas të gjitha gjasave gjatë nxjerrjes së gjuhës gjatë autopsisë. Për ilustrim, lloji i njëjtë i lëndimit shihet në një pjesë të autopsisë së gjuhës e publikuar në literaturë (Kurhara et al. 1992.) Disa dilaseratione, në lidhje me nxjerrën e gjuhës dhe të faringut në nivel të plagës, janë të një aspekti të ngjashëm dhe shihen në videot dhe fotografitë e autopsisë. Hipoteza e propozuar nga mjekët ligjorë të dihet se dilacerationet janë provokuar nga një presion i tepërt në gjuhë gjatë një mbylljeje të pjesës së thellë të kavitetit bukal (qiellza e fortë) përballë një objekti të fortë, ne nuk na duket i mundshëm për arsye të mungesës të shenjës së vitalitetit përreth lëndimeve si dhe nga morfologjia e këtyre lëndimeve. Për ndryshe, ne nuk kemi gjetur gjurmë të një mekanizmi në literaturën mjeko-ligjore.

Petechiae subpleural (njollat e Tardieu) mund të shihen në rast të një asfiksie por nuk janë specifike të këtij mekanizmi (Saukko end Kinght 2016).

Fraktura e brinjës së 4<sup>te</sup> të majtë, ka mundur të shkaktohet nga matjet e rianimit pa e përjashtuar ndonjë mekanizëm tjetër (trauma tjera të hapura).

Zonat e ngjyrymeve kuq-vjollce në mukozë të qiellzës së butë, që evokojnë infiltrime hemorragjike, janë pasojë e traumave të hapura (përplasja e trupit kundër një objekti të hapur, goditur nga një objekt i hapur). Ato mund të jenë me origjinë ndikimit nga fundi i shishes prej plastike përballë mukozës.

Edeme pulmonare hemorragjike akute dhe e përhapur është një konstatim klasik i asfiksisë violente edhe pas patofiziologjia e saj mund të debatohet. Kemi të bëjmë me një shenjë jo specifike.

Bronkoaspiracioni akut dhe i përhapur i materialit ushqimor, në gjirin e rrugëve ajrore, tregon se shishja e plastikës nuk e mbyllte tërësisht hapjen e laringut (aditus larynge) dhe se materiali ushqimor i pranishëm në lukth ka mundur të ngjitet në ezofag, kalon në faring pastaj në laring, në trake pastaj në mushkëri. Vjellët ishin, sipas të gjitha gjasave, në lidhje me stimulimin nga shishja e plastikës i receptorëve të refleksit e pranishme edhe neveria në gojë dhe në faring.

b. Komentimet për shkakun e vdekjes

Në bazë të të gjitha konstatimet dhe ne duke u bazuar mbi të dhënat nga literatura, mund të përfundojmë se vdekja e z. DEHARI Astrit është rezultat e asfiksisë.

Nga një pikëpamje teorike, asfiksia përkufizohet si një ndërprerje e furnizim, i bartjes dhe përdorimit të oksigjenit drejt organeve të trupit (Dettmeyer dhe al. 2014, Saukko and Knight 2016, Spitz 2006). Truri është organi më i ndjeshëm në mungesë të oksigjenit, pra është që më së shpeshti preket i pari. Një kalifikim i unifikuar i asfiksisë ka qenë propozuar nga A. Sauvageau dhe E. Boghossian (2010) që i ndante asfiksitë në katër grupe:

- grupi i ngulfatjeve (ang “suffocatio”) nënkupton:
  - o ngulfatjen e llojit *smothering* që ka të bëjë me një obstrukcion të rrugëve ajrore mbi epiglotë,
  - o ngulfatjen e llojit *choking* që ka të bëjë me një obstrukcion të rrugëve ajrore nën epiglotë,
  - o ngulfatje në hapësirat e mbyllura (sh. Me thes plastike), i llojit varrosjes (sh. Futja e kokës në rërë) ose në atmosfera të ndotura (sh. Helmimi me monoksid të karbonit),
- grupi i bllokimit, që kate bëjë me një asfiksion me mbylljen e enëve të gjakut dhe të rrugëve ajrore në nivelin e qafës n duke u lidhur me një kompresion të jashtëm që nënkupton;
  - o me varjes që korrespondon me një shtypje trunore që lidhet me peshën e trupit,
  - o me bllokimin përmes litarit që lidhet me një shtypje trunore që lidhet me një forcë tjetër përveç peshës së trupit,
  - o me bllokimin manual që lidhet me një shtypje trunore nga njëra apo të dy duart ose me pjesë tjera të gjymtyrëve,
- grupi i asfiksimeve mekanike nënkupton:
  - o asfiksioni i pozicional që lidhet me një pozitë të trupit e cila pengon frymëmarrjen,
  - o asfiksioni traumatik i shkaktuar me një shtypje mbi toraks me një objekt të rëndë ose nga një person,
- grupi i fundosjes në ujë.

Zvogëlimi ose ndërprerja e tërësishme e sjelljes së gjakut të oksigjenuar në tru shkakton një humbje të vetëdijes dhe një të tonusit muskolor. Kjo humbje e tonusit muskolor i bën të pamundura të gjitha manovrimet e vetë-ngulfatjes manuale ose me litar. Në veçanti kjo bën të pamundur vetë-ngulfatjen duke mbajtur një objekt në rrugët ajrore. Një vetë-ngulfatje duke mbajtur një objekt në mënyrë pasive në rrugët e ajrit (sh. Vendosja e një leckë) mbetet gjithnjë e mundshme.

Diagnoza e asfiksimit në rastin e z. DEHARI Astrit mbështetet në praninë e shenjave “klasike” të asfiksimit (Madea 2016; Saukko and Knigh 2016), edhe pse këto të fundit mund të jenë jo shumë specifike (Saukko and Knigh 2016), siç dihet prania e petechies (pikës lëkurore ngjyrë e kuqe në vjollce) konjunktivale bilaterale, petechies subpleurale (njollë e Tardieu), të një edeme pulmonare hemorragjike akute dhe e një kongestion pulmonar.

Sa i përket mekanizmit të asfiksisë në rastin e z. DEHARI Astrit, kemi të bëjmë saktësisht me një mekanizëm me ngulfatje të llojit smothering (Sauva geau and Boghossian 2010) me një objekt me përbërje të fortë (një shishe plastike). Siç është përshkruar më lartë, ngulfataja e llojit *smothering* është përkufizuar si obstrukcion i rrugëve ajrore mbi epiglotë, në këtë rast për shkak të një shisheje prej plastike që mbyllë rrugët ajrore në nivelin e gojës dhe të faringut. Ka të ngjarë që prania e infiltrimeve hemorragjike të vendosura në nivelin e qiellzës së butë shkon në drejtim të kësaj diagnoze. Që të rikujtojmë, rrugët ajrore përbëhen, nga lartë poshtë, me zgavrat nazale, me zgavrat orale, me faringun, me trakenë, me bronket dhe mushkëritë. Epiglota është një strukturë anatomike që mundëson të ndajë faringun dhe laringun. Në rastin e z. DEHARI, shishja është gjetur e futur në gojë nga fundi, baza e saj që ka madhësi prej 6cm të diametrit. Matjet anatomike të laringur të kryera nga Eckel dhe al. (1994) mundësojnë të vlerësohet se diametri normal i vrimës së laringut (aditus) është mesatarisht 3,82cm (minimum 27mm dhe maksimumi 63mm) tek njeriu. Sa i përket asaj se kjo matje bazohet mbi distancën në mes të strukturave të kartilagut (kërcit) të cilat e kufizojnë vrimën e laringut (briri i sipërm i kërcit tiroide), kjo vlerë është e mbivlerësuar sepse ajo nuk nënkupton indet e buta të cilët mbulojnë strukturat e kartilagut (kërcit). Baza e shishes prej plastike do të duhet të gjendej mbi epiglotë. Një argument tjetër që shkon në këtë drejtim të konstatimit është prania e madhe bronkoaspirationit të materieve ushqimore. Në fakt, në mënyrë që një bronkoaspiration i tillë të ndodh, është e nevojshme që drita e laringut të jetë e lirë. Në këtë lloj mekanizmi, disa njolla të izoluar mund të shihen në nivelin e konjunktivave (Madea 2016), çfarë ishte rasti i z. DEHARI Astrit.

Prandaj, një kombinim me mekanizmat tjerë nuk mund të përjashtohet. Në fakt, gjatë autopsisë e z. DEHARI Astrit, lëndimet në regjionin cervical ishin të dukshme (ecchymosis<sup>13</sup> në nivelin e këndit të mandibulës së djathtë dhe të skajit antero-inferior të djathtë të mandibulës, pllaka pergamene në pjesën laterale të djathtë të qafës, me madhësi dhe formë të ndryshme, disa nga të cilat në formë harku).

Raporti i autopsisë tregon, se mekanizmi potencial i vdekjes, është një ndërprerje reflekse të aktivitetit kardiak i shkaktuar nga shishja e vendosur në gojë. Ky mekanizëm i vdekjes është i njohur nën emrin “bolus death” në literaturën shkencore. Kjo përcaktohet si një vdekje e shkaktuar nga një obstrukcion i laringut ose i pjesëve inferiore të faringut, e shoqëruar me një ndërprerje kardiake reflekse (Madea 2016). Nuk kemi të bëjmë me një vdekje me asfiksi. Prania e shenjave të asfiksisë, mungesa e obstrukcionit të laringut ose të pjesëve inferiore të faringut si dhe konstatimet e një pulsi dhe të një frymëmarrjeje të bëra nga infermierja e qendrës së paraburgimit të Prizrenit (anëtarja e parë e personelit mjekësor që e ka ekzaminuar z. DEHARI),

<sup>13</sup> Zhvendosja e indit socio-lëkuror pas një tronditjeje, ku paraqiten njolla të kaltra.

mundësojnë të përjashtohet vdekja me ndërprerje reflekse të aktivitetit kardial ("bolus death"), ashtu siç është thënë në raport të autopsisë.

#### e. Komentet për rrethanat e vdekjes

Në bazë të të gjitha këtyre konstatimeve dhe ne duke u bazuar mbi të dhënat e literaturës, ne mundë të bëjmë komentimet e mëposhtme:

- Në hipotezën e shkakimit të vetëvrasjeje, kemi të bëjmë me një vetëvrasje komplekse të paplanifikuar. Në literaturën mjeko-ligjore (Germerott et al. 2010), është bërë një dallim në mes vetëvrasjes së thjeshtë dhe vetëvrasjes komplekse, e para përdor vetëm një metodë ndërsa e dyta përdorë shumë metoda. Sipas të dhënave të literaturës, vetëvrasjet komplekse janë përshkruar në 1,5 deri në 5% në të gjitha vetëvrasjet dhe implikojnë shpesh individë me sëmundje psikiatrike sikur që janë çrregullimet e personalitetit, depresioni ose skizofrenia (Germerott et al. 2010). Vetëvrasja komplekse mund të ndahet në "të planifikuar" ose "të paplanifikuar" në funksion të përdorimit të njëkohshëm ose skuenciale të metodave respektive. Në vetëvrasjet komplekse të paplanifikuara, mortaliteti i metodës së parë është i dobët në të shumtën e rasteve dhe për shkak të dhimbjes dhe të frustrimit për dështimin e metodës së parë, një metodë shtesë më shkatërruese është përdorur (Germerott et al. 2010). Në rastin e z. DEHARI, nëse e pranojmë hipotezën e vetëvrasjes, të dy metodat do të ishin përdorur në mënyrë sequenciale, e para ka të bëjë me përdorimin e një objekti të mprehtë në pjesën e qafës dhe të kyçit të majtë dhe e dyta ka të bëjë me ngulfatjen e llojit *smithering* me një sheshe të plastikës. Megjithatë, kjo hipotezë duket pak e mundshme për arsyet e më poshtme: së pari lëndimet cervikale dhe të kyçit ishin shumë sipërfaqësore, që nuk tregonin përcaktime të vërteta të aktit vetëvrasës; e dyta, teoria e vetëvrasjeve komplekse të paplanifikuara që ka dëshiruar z. DEHARI, duke parë këtë tentativë të pasuksesshme, e zgjedh metodën e dytë të vetëvrasjes më vdekjeprurëse, çfarë nuk ishte rasti. Në fakt ai është kthyer drejt një ngulfatjeje të vetë-shkaktuar, një metodë komplekse, efikasiteti i dobët është shumë i rrallë (kjo lloj ngulfatjeje verëvrasëse është përshkruar në literaturë vetëm në raste të rralla); si e tretë, kjo lloj vetëvrasjeje kryesisht haset tek pacientët psikiatrikë pra që z. DEHARI nuk paraqiste asnjë paraardhje psikiatrike dhe nuk paraqiste shenja të depresionit. Ndër të tjera sipas njohurive tona, kurrë nuk është përshkruar, në literaturë, vetëvrasja komplekse që implikon një ngulfatje të llojit *smithering* e paraprirë nga përdorimi i një objekti të mprehtë.
- Në literaturë ne kemi hasur vetëm dy raste të përdorimit të ngulfatjes së llojit *smithering* si mënyrë e vetëvrasjes (Di Vella et al. 2002 ; Viero et al. 2016). Në rastin e parë, kemi të bëjmë me vendosjen e ngjitsit rreth kokës, që i bllokonte rrugët respiratorë (Di Vella et al. 2002). Në rastin e dytë kemi të bëjmë me një futje të peshqirit dhe të dorezave prej kauçuku dhe qumështit në rrugët ajrore, mbi epiglotë. Në këtë rastin e fundit vërejmë se kemi të bëjmë me karakteristika të objekteve të



futura ( dhe në veçanti poroziteti i peshqirëve të cilët që futen në mukoza) që e bënte të pamundur hapësirën spontane të rrugëve ajrore thjeshtë me rrëshqitjen e materialit të përdorur. Në rastin e z. DEHARI Astrit, nëse e pranojmë hipotezën e vetëvrasjes, pasi që ka vendosur shishen hipotetike në gjirin e gojës dhe e ka mbajtur aktivisht vetë viktima këtë të fundit, një fazë e humbjes së vetëdijes do të paraqitet për shkak të hipoksisë cerebrale, konsektive në obstruksionin e stërzgatur të rrugëve ajrore. Në këtë moment, tonusi muskolor do të lëshohet dhe duart nuk do të mund të mbanin shishen. Në faktin se shishja është plastike dhe me skaje të lëmuara, e rumbullakët dhe pa rrethe, kjo nuk do të ishte e mundur të qëndronte e ngulitur në faring në mënyrë të një obstruksioni të tërësishëm. Një skenar eventual i mudnshëm (por jo i përcaktuar nga DiMiao dhe DiMiao) do të ishte që viktima të shtrihet në bark dhe kur ta humb vetëdijen, shishja e përqendruar në mes kokës dhe tokës vazhdon në mënyrë efikase të mbyllë rrugët ajrore. Kemi të bëjmë me një eventualitet shumë të pamundur, pasi që duhet të kemi parasysh gjithashtu, se gjatë fazës së futjes që karakterizon asfiksionin, lëvizjet e trupit do ta pengojnë ruajtjen e kësaj pozite, me rrëshqitjen e shishes dhe lirim të rrugëve ajrore. Megjithatë duhet të nënvizojmë se skenari i fundit i komentuar nuk mund të merret parasysh në rastin e z. DEHARI sepse trupi i tij është gjetur në dekumitus dorsal, ashtu siç dëshmohet nga të gjithë dëshmitarët.

- Rastet tjera të vetëvrasjeve me ngulfatje që implikojnë objekte në rrugët ajrore janë përshkruar në literaturë (Germerott et al. 2010; Morgan et al. 2010; Saint-Martin et al. 2007; Sauvageau et al. 2006; Saukko and Knigh 2016), por konsistojnë në ngulfatjet e llojit *choking*, duke mbyllur rrugët ajrore nëm epiglotë (pluhur talcum, sumac helmues, peshqirë, letër gazetash, poliuretani të ndërtimit, plastikë, falkon medikamentesh). Në këto raste, viktimat ishin shpesh të njohura me çrregullime psikiatrike. Për të rikujtuar z. DEHARI Astrit nuk vuan nga çrregullimet mendore dhe në rastin e tij shishja gjendje mbi epiglotë.
- Ngulfatja e llojit *Smothering* në rastet e vrasjeve, ka të bëjë me një material të futur në rrugët ajrore që janë përshkruar nga literatura (nga sh. Boghossian et al. 2010 (2 raste); Kurihara et al. 1992; Saint-Martin et al. 2012. Në rastin e Kuriharas et al. (1992), obstruksioni i rrugëve ajrore ishte kryer në nivelin e laringo-faringut me ndihmën e peshqirëve letër. Ekzaminimi në veçanti ka zbuluar praninë e pikave konjunktive, plagë dhe gërvishjeve në nivelin e qafës. Në rastin Saint-Martin et al. (2012) obstruksioni i rrugëve ajrore ishte kryer në nivelin e laringo-faringut me ndihmën e letres së tualetit. Në këtë rast, ekzaminimi i jashtëm zbuloi lëndime në nivelin e qafës dhe të fytyrës (ecchymosis) dhe në parakrah (ecchymosis) dhe gërvishje. Në serinë e rasteve të Boghossian et al. (2010) obstruksioni i rrugëve ajrore ishte kryer në një rast me kravatë dhe në dy rastet tjera me doreza. Sipas Boghossian et al. (2010) dhe të DiMaio and DiMaio (2001), vrasje me ngulfatje të

llojit Smothering është shumë e vështirë mbi një të rritur duke pasur parasysh aftësitë e tij.

- Në rastin e z. DEHARI Astrit, autopsia ka zbuluar praninë e lëndimeve të shtypura në nivelin e regjionit frontal superior, të pjesës inferiore të fytyrës së djathtë, të pjesës laterale të djathtë të qafës, të parakrahut të djathtë dhe të dorës së djathtë. Këto lëndime nuk mund të shpjegohen me një veprim vetëvrasës me armë të mprehtë dhe ngulfatje. Hipoteza e lëndimeve të shkaktuara nga transporti i trupit, nuk i shpjegojnë në tërësi këto konstatime dhe nuk ngjajnë shumë bindëse.

## V. PËRFUNDIMET

Në vazhdim të rishikimit të hetimeve të policisë, mjekëve-ligjorë dhe mjekëve-psiko-socialë që e rrethojnë z. DEHARI Astrit, ne mund të nxjerrim konkludimet në vazhdim:

1. Vdekja e z. DEHARI Astrit është rezultat i asfiksionit, sigurisht me ngulfatje të llojit *Smothering*.
2. Objekti i gjetur në gojë (shishja me mjalte) ka mundur të përdoret për të mbyllur rrugët ajrore të z. DEHARI Astrit.
3. Plagët sipërfaqësore, të vërejtura në nivelin e regjionit latero-cervical të djathtë dhe të kyçit të majtë, janë pasoja të traumave të provokuara nga një objekt i mprehtë dhe, sipas lokalizimit, tregojnë së pari lëndime të vetë-kryera. Nga fakti i karakterit të tyre sipërfaqësore dhe se z. DEHARI Astrit kishte njohuri mjekësore, këto lëndime me vështirësi janë shkaktuar nga autori me qëllim që të shkaktojë vdekjen. Hipoteza se lëndimet janë shkaktuar nga një person i tretë me qëllim të maskimit të krimit duhet të evokohet dhe përjashtohet.
4. Disa lëndime të konstatuara mbi trupin e z. DEHARI Astrit nuk janë përshkruar nga mjekët ligjorë të cilët e kanë kryer autopsinë dhe të tjerat nuk janë marrë parasysh në konkluzionet përfundimtare të raportit të autopsisë:
  - Lëndimet me shtypje janë gjetur në nivelin e pjesës laterale të djathtë të fytyrës dhe të pjesës laterale të djathtë të qafës. Nga lokalizimi i tyre, origjina aksidentale e këtyre lëndimeve duket pak e mundshme. Një mekanizëm sikurse kompresioni cervical manual do të jetë ndoshta shkak i tij.
  - Lëndimet me shtypje janë gjetur në nivelin e parakrahut të djathtë. Edhe pse jo specifike, këto mund të jenë shkaktuar nga mbërthimi i krahut, por pa pasur mundësi ne të përjashtojmë ndonjë shkaktar tjetër.
  - Duke pasur parasysh se çka paraprinë, shumë lëndime të pranishme mbi trupin e z. DEHARI Astrit nuk janë shpjeguar në mënyrë bindëse (transporti i trupit, procesi i rianimit mjekësor "konvulsionet" që shoqërojnë obstrukcionin e rrugëve ajrore), por mund të interpretohen si lëndime që evokojnë intervenimin e një personi të tretë (lëndimet me shtypje në nivelin e pjesës inferiore të djathtë të fytyrës, të pjesës laterale të djathtë të qafës, të parakrahut të djathtë dhe të dorës së djathtë).
5. Si përfundim, hipoteza e vetëvrasjes së z. DEHARI Astrit me mjetet e paraqitura nga mjekët ligjor nuk duket e vërtetë. Për këtë arsye rrethanat e vdekjes së z. DEHARI Astrit janë, sipas mendimit tonë, të përfshira me një dyshim të intervenimit të personit të tretë në procesin fatal. Ekzaminimet plotësuese janë të nevojshme për të përjashtuar intervenimin e personit të tretë në vdekjen e z. DEHARI Astrit.

## VII VËREJTJE DHE PROPOZIME:

Më 25 maj 2019, ne kemi pranuar materialin që ka të bëjë me këtë çështje, i cili është transferuar në Njësinë tonë të Gjenetikës Forensike. Analiza e këtij materiali do të mund të jepte më shumë elemente për të ndriçuar rrethanat e vdekjes së z. DEHARI Astrit. Për këtë fakt, një raport që ka të bëjë me analizën e këtij materiali ju do t'ju mbërrij më vonë në formë të një ekspertize plotësuese.

Ne jemi në dispozicion tuajin për ndonjë analizë toksikologjike plotësuese.

(nënshkrimi i palexueshëm)

14.06.19

**Dr. D AGUIAR**

Mjekësi interne

(nënshkrimi i palexueshëm)

17.06.19

**Prof Dr med. T. FRACASSO**

Specialist FHM në mjekësi ligjore

Mjek-shef

(nënshkrimi i palexueshëm)

20.06.19

**Prof. Dre med. S. GRABHERR**

Specialist FHM në mjekësi ligjore

Drejtoreshë e CURML